EPOKA E RE
E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5479
E premte, 18 maj 2018
çmimi 0.40 €

Kuvendi miraton Projektligjin për mësimdhënësit e viteve të '90-ta FAQE 7



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", AFRIM HOTI FAQE 4-5

# Samiti i Sofjes, shans i BE-së për Ballkanin Perëndimor



## - Pavarësisht prej problemeve të brendshme, BE-ja nuk e ka anashkaluar Kosovën

Profesori i marrëdhënieve ndërkombëtare, Afrim Hoti, ka thënë se për Kosovën është sukses pjesëmarrja në Samitin e Sofjes dhe trajtimi i njëjtë me vendet e tjera. Sipas tij, Kosova është faktor dhe nuk mund të flitet për Ballkanin Perëndimor pa Kosovën, madje edhe në rastet kur disa vende hezitojnë. Hoti ka vlerësuar se ky samit është shans dhe përkushtim i Bashkimit Evropian për vendet e Ballkanit Perëndimor. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se ka një garë në mes të BE-së, Rusisë dhe Turqisë për ta shtrirë ndikimin në Ballkan dhe, sipas Hotit, BE-ja e ka marrë seriozisht këtë sinjal dhe përmes samitit u jep prioritet kushteve që duhet t'i plotësojnë vendet e Ballkanit Perëndimor



Bashkimi Evropian dhe shtetet e Ballkanit Perëndimor dalin me deklaratë të përbashkët në Samitin e Sofjes FAQE 3

# Kosova e barabartë me shtetet e tjera

Republika e Kosovës është trajtuar plotësisht e barabartë sikur shtetet e tjera në Samitin e Bashkimit Evropian me vendet e Ballkanit Perëndimor që është mbajtur të enjten në Sofje. Në deklaratën e përbashkët të këtij samiti është konfirmuar vendosmëria e BE-së për të ardhmen evropiane të rajonit. Po ashtu, kjo deklaratë ka kërkuar prej vendeve të rajonit t'i përforcojnë më tutje marrëdhëniet fqinjësore dhe bashkëpunimin e ndërsjellë

## Drejtorët e policive rajonale diskutojnë për luftën kundër krimit dhe terrorizmit

FAQE 5



### AKTUALE



200 STUDENTË DO TË ANGAZHOHEN PËR PUNË PRAKTIKE NË INSTITUCIONE F. 6

PAGESAT E POLICËS KUFITARE BËHEN 'ONLINE' F. 7

### EKONOMI

LANSOHET FONDI PËR INOVACION DHE NDËRMARRËSI PËR ORGANIZATAT JOQEVERITARE F. 7

KOSOVA PËR TRE MUAJ KA IMPORTUAR 119.2 GWH ENERGJI ELEKTRIKE F. 8

### KULTURË

QUARTET SOCIOLOGICA F. 7
ALI PAJAZITI

FRANKENSTEINI NË BAGDAD F. 7
AHMED SAADAWI

### SPORT

GASHI: KËTË VIT DO TË INVESTOJMË SHUMË NË SPORT F. 18

DALLKU: TË DHUROJMË SPEKTAKËL DHE TË SHPALLEMI KAMPIONË F. 18

RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht -Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

SatStyro
Mushnikovë-Prizren-Kosovë
SatStyro
Product of EPS and XPS
Mob.: +377(0) 44 506 815
Tel&Fax.: +381(0) 29 246 030
e-mail: sat_styro@yahoo.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

# Zaevi: Një opsion për emrin i pranueshëm për të dyja palët

Zaevi ka thënë se zgjidhja e pranueshme për të dyja palët do t'i hapte mundësinë mbylljes përfundimtare të kontestit, që do të ishte inkurajim për shtetet anëtare të BE-së dhe të NATO-s, për t'ia hapur rrugën anëtarësimit të Maqedonisë në këto institucione




Shkup, 17 maj - Kryeministri i Maqedonisë, Zoran Zaev, ka deklaruar se bashkë me homologun nga Greqia, Aleksis Tsipras, kanë ardhur deri te një opsion i pranueshëm për të dyja palët rreth kontestit për emrin e Maqedonisë. Zaevi dhe Tsipras kanë biseduar në Sofje të Bullgarisë, ku po mbahet Samiti i BE-së për Ballkanin Perëndimor. "Një nga opsionet është zgjidhje e pranueshme për të dyja palët. Ne do t'i vazhdojmë konsultimet me vendet tona që të shohim nëse një zgjidhje e tillë është e mundshme të zbatohet nga institucionet e sistemit dhe nëse është e mundur, me siguri se do të kemi zgjidhje. Unë jam Zorani, ndërsa partneri im është Aleksisi dhe ne jemi vetëm se njerëz, pra duhet të mbajmë llogari se si kjo mund të zbatohet në mënyrë institucionale. Duhet të bisedojmë me presidentët e dy shteteve, me liderët e opozitës për të gjitha detajet që kanë të bëjnë me këtë çështje", ka deklaruar Zaevi, pa dhënë detaje për zgjidhjen e mundshme, apo opsionin, siç e përmendi ai.

Zaevi ka thënë se kjo zgjidhje do t'i hapte mundësinë mbylljes përfundimtare të kontestit, që do të ishte inkurajim për shtetet anëtare të BE-së dhe të NATO-s, për t'i hapur rrugën anëtarësimit të Maqedonisë në këto institucione. Në rast se dështon edhe ky opsion, Zaevi ka deklaruar se të dyja palët nuk do të zmbrapsen nga bisedimet, por do t'i vazhdojnë përpjekjet deri në arritjen e saj. "Dëshira jonë është që tani të ketë zgjidhje, pasi do të ishte inkurajim për Këshillin Evropian pasi, siç e dimë, në fund të qershorit do të mbahet Samiti evropian. Në korrik do të ketë edhe samit të NATO-s që, gjithashtu, do të ishte një inkurajim plus për një ftesë për ne për anëtarësim. Por, nëse kjo nuk bëhet, apo nuk ka zgjidhje, ne do të vazhdojmë kërkimin e zgjidhjes derisa të arrijmë marrëveshje", ka deklaruar Zaevi. Ai ka theksuar se me homologun grek kanë miratuar të gjithë progresin e deritashëm të arritur në bisedimet që janë zhvilluar nga shefat e diplomacive të dy vendeve.

Mediet në Shkup kanë raportuar për një zgjidhje të mundshme, por zbatimi i së cilës do të realizohej në faza. Maqedonia, sipas medieve, do të pranonte një emër të ri, me gjasë "Republika e Maqedonisë Veriore", për përdorim të gjithanshëm, si brenda ashtu edhe në relacionet ndërkombëtare, por kjo zgjidhje të hynte në fuqi paralelisht me procesin e integrimit të vendit të NATO dhe BE. Greqia, siç bëhet me dije, do ta pranonte anëtarësimin në NATO, por ratifikimi në Parlamentin e Greqisë do të bëhej në momentin kur Maqedonia do t'i bënte ndryshimet kushtetuese për zyrtarizimin e emrit të ri, sipas formulës "erga omnes".

Veç kësaj, Maqedonia do ta merrte edhe datën për fillimin e bisedimeve për anëtarësim në Bashkimin Evropian, por edhe ky proces nuk do të mbyllet pa zbatimin e plotë të marrëveshjes eventuale me Greqinë.

Njoftimet mbi një marrëveshje të tillë, që do ta përfshinte edhe zgjidhjen e çështjes së gjuhës maqedonase, ka nxitur reagimin e opozitës, e cila tani disa ditë kërkon takim të liderëve të partive politike.

## Kryemadhi: Rama po e çon parlamentarizmin drejt vdekjes



Tiranë, 17 maj - Kryetarja e Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, Monika Kryemadhi, në një prononcim për mediet jashtë ambienteve të Kuvendit akuzoi kryeministrin Edi Rama se po merr peng institucionet për të cilat shqiptarët kanë luftuar për 27 vjet me radhë. Sipas Kryemadhit, seanca e sotme dëshmoi se parlamentarizmi ka vdekur, pasi nuk po i jepet mundësia opozitës ta denoncojë me fakte qeverinë e inkriminuar.

Kryemadhi shprehu bindjen se tashmë koha e drejtësisë po vjen dhe këtë drejtësi, sipas saj, nuk do ta sjellë as Arta Marku, as Prela, por vetë populli.

"Parlamentarizmi në Shqipëri është drejt fundit për shkak të uzurpimit që Rilindja ua ka bërë institucioneve. Shkelja e sistemit tregon frikën e Ramës me faktet dhe drejtësinë. Koha e drejtësisë po vjen. Nuk do të vijë as nga Marku, as nga Prela, por nga populli. Kjo e sotmja tregon kapjen e sistemit, institucioneve. Pas 27 vjetësh gjithë ky institucion është në duart e bandave. Asnjë shqiptar nuk do të lejojë që Rama t'i cenojë fëmijët e tyre. Unë nuk do ta lejoj, as të tjerët nuk do ta lejojnë", tha Kryemadhi, duke shtuar se çështja e protestave të reja të opozitës është diçka që do të shihet hap pas hapi.

## Basha: Ja skenari i Edi Ramës




Tiranë, 17 maj - Lideri i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, në një konferencë të jashtëzakonshme për media, ka akuzuar kryeministrin Edi Rama dhe ministrin Fatmir Xhafaj se po manipulojnë provat kundër vëllait të ministrit të Brendshëm. "Qëllimi i përcjelljes së Agron Xhafajt nuk është vuajta e dënimit, por për të krijuar alibinë se përse Prokuroria e Ramës dhe policia nuk e procedojnë dot për trafikun aktual të drogës. Prokuroria dhe Policia po ushtrojnë terror prej 72 orësh ndaj familjes së dëshmitarët. Presion po ushtrojnë dhe figura të krimit të organizuar. Qëllimi është vetëm një: komprometimi me çdo kusht i dëshmitarit dhe shkatërrimi i prove", tha Basha, i cili prezantoi dhe një video të dëshmitarit X, i cili quhet Albert Veliu dhe tregoi për lidhjet me vëllanë e Fatmir Xhafajt.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

### Bashkimi Evropian dhe shtetet e Ballkanit Perëndimor dalin me deklaratë të përbashkët në Samitin e Sofjes

# Kosova e barabartë me shtetet e tjera

**Republika e Kosovës është trajtuar plotësisht e barabartë sikur shtetet e tjera në Samitin e Bashkimit Evropian me vendet e Ballkanit Perëndimor që është mbajtur të enjten në Sofje. Në deklaratën e përbashkët të këtij samiti është konfirmuar vendosmëria e BE-së për të ardhmen evropiane të rajonit. Po në këtë deklaratë është kërkuar prej vendeve të rajonit t'i përforcojnë më tutje marrëdhëniet fqinjësore dhe bashkëpunimin e ndërsjellë**



EPOKA E RE Muhamet KOCI

Sofje, 17 maj - Bashkimi Evropian (BE) dhe shtetet e Ballkanit Perëndimor kanë konfirmuar në Samitin e Sofjes përkushtimin dhe vendosmërinë për të ardhmen evropiane të rajonit. Në deklaratën e përbashkët të këtij samiti, ku Republika e Kosovës është trajtuar shtet i barabartë me shtetet e tjera, ka nxjerrë si përfundim edhe përkushtimin për thellimin e bashkëpunimit dhe rritjen e stabilitetit në rajon, si parakusht për integrimin e kësaj pjese të Evropës në kuadër të Bashkimit Evropian. "BE-ja mbështet angazhimin e partnerëve të Ballkanit Perëndimor për t'i përforcuar më tutje marrëdhëniet fqinjësore të mira, qëndrueshmërinë rajonale dhe bashkëpunimin e ndërsjellë", është thënë në deklaratë.

Në njërën nga 17 pikat e kësaj deklarate, theksohet shtimi i angazhimeve për forcimin e rendit dhe ligjit, për luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit, për respektimin e të drejtave të minoritarëve dhe të njëri-tjetrit, dhe në ndërtimin e urave të bashkëpunimit.

Pas samitit, presidenti i Këshillit Evropian, Donald Tusk, ka thënë se Ballkani Perëndimor është dhe do të jetë pjesë integrale e Evropës, përkatësisht BE-së. "Unë nuk shoh ndonjë të ardhme tjetër për Ballkanin Perëndimor përveç BE-së. Nuk ka alternativë, asnjë plan 'B'. Ballkani Perëndimor është pjesë integrale e Evropës dhe ata i përkasin komunitetit tonë" ka thënë Tusk në një konferencë të përbashkët me presidentin e Komisionit Evropian, Jean-Claude Juncker dhe kryeministrin bullgar Boyko Borissov.

Pjesë e këtij Samiti të BE-së me vendet e Ballkanit Perëndimor ishte edhe Kosova, e cila është trajtuar shtet i barabartë me shtetet e tjera pjesëmarrje. Presidenti i vendit, Hashim Thaçi, në hapjen e punimeve të seancës plenare të Samitit të Sofjes, ku është trajtuar tema "Fuqizimi i të gjithë dimensioneve të ndërlidhjes (socio-



ekonomike, fizike, digjitale dhe njerëzore)", ka thënë se ky samit po zhvillohet në një moment të rëndësishëm për Bashkimin Evropian dhe Ballkanin Perëndimor. "Ky samit midis Bashkimit Evropian dhe Ballkanit Perëndimor është një sukses i jashtëzakonshëm i përbashkët, në veçanti i nikoqirëve tanë, presidencës bullgare. Suksesi i këtij samiti bazohet në ruajtjen e angazhimit me shtetet e Ballkanit Perëndimor përmes një qasjeje gjithëpërfshirëse dhe të barabartë, si dhe mbështetet në parimin e rëndësishëm sipas të cilit i gjithë Ballkani Perëndimor gëzon një perspektivë evropiane", ka thënë presidenti Thaçi.

Kreu i shtetit ka thënë se kjo përfshinë strategjinë e muajit shkurt të Komisionit Evropian për Ballkanin Perëndimor, angazhimin përmes nismave të shumta, në mesin e tyre edhe Procesi i Berlinit, agjenda e ndërlidhjes dhe plani shumëvjeçar i veprimit për Zonën Ekonomike Rajonale, si dhe forume të tjera që synojnë t'i afrojnë shtetet e Ballkanit Perëndimor me njëra-tjetrën dhe më pranë Bashkimit Evropian. "Kam kënaqësinë që personalisht ta konfirmoj mbështetjen e Kosovës për përmbajtjen e deklaratës së këtij samiti dhe të agjendës prioritare të Sofjes. Ne i mbështesim plotësisht parimet kyçe të bashkëpunimit të forcuar, marrëdhënieve të mira fqinjësore dhe nevojës për zgjidhje të qëndrueshme dhe të detyrueshme të mosmarrëveshjeve dypalëshe", ka thënë presidenti Thaçi.

Para liderëve evropianë e ballkanikë Thaçi ka thënë se Kosova është dhe do të mbetet plotësisht e përkushtuar ndaj këtyre qëllimeve, duke përfshirë dialogun e lehtësuar nga BE-ja për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. "Kosova është e gatshme të hyjë në fazën përfundimtare të dialogut me Serbinë për arritjen e një marrëveshjeje ligjërisht detyruese për normalizimin e marrëdhënieve dhe pajtimin. Më lejoni të theksoj nevojën për rregulla të barabarta të lojës tani që po lëvizim drejt zbatimit të mëtejshëm të temave që po diskutojmë në këtë samit dhe në rastin e Kosovës kjo përfshin një përmbyllje të shpejtë të procesit të liberalizimit të vizave për të cilin Kosova ka përmbushur të gjitha 95 kriteret e kërkuara", është shprehur ai.

Presidenti Thaçi gjatë këtij samiti ka takuar edhe udhëheqësit e BE-së dhe ata të vendeve evropiane, duke përfshirë presidentin e Francës, Emmanuel Macron dhe kancelaren gjermane Angela Merkel. Në Samitin e BE-së për Ballkanin kanë marrë pjesë liderët nga gjashtë shtetet e Ballkanit Perëndimor, Shqipëria, Kosova, Bosnja dhe Hercegovina, Serbia, Mali i Zi dhe Maqedonia. Kurse nga Bashkimi Evropian kanë marrë pjesë presidenti i Këshillit Evropian, Donald Tusk, kryesues i takimit, pastaj presidenti i Parlamentit Evropian, Antonio Tajani, përfaqësuesja e Lartë e BE-së për Politikë të Jashtme dhe Siguri, Federica Mogherini dhe komisionari për Politikat e Fqinjësisë Evropiane dhe Negociatat e Zgjerimit, Johannes Hahn.

Përveç presidentit Hashim Thaçi, Kosova në këtë samit ka qenë e përfaqësuar edhe nga kryeministri Ramush Haradinaj dhe nga ministri i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli.

Nikoqir i këtij samiti ishte kryeministri i Bullgarisë, Bojko Borisov, i cili aktualisht mbanë edhe Presidencën e Këshillit.

## Thaçi nënshkruan deklaratën "që ul koston e romingut në rajon dhe BE"

Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka bërë me dije se është nënshkruar, në deklaratën e përbashkët me përfaqësuesit e vendeve të tjera të Ballkanit Perëndimor, e cila ka dalë si rezultat i Samitit të Sofjes. Në profilin e vet në "Facebook" ai ka shkruar ky është një hap konkret drejt uljes së kostos së romingut në rajon dhe me Bashkimin Evropian. "Jetësimi i kësaj agjende digjitale është një lajm shumë i mirë për të gjithë konsumatorët dhe një përfitim i qartë i procesit të integrimit. Gjithashtu, kjo do të ndihmojë edhe nisjen e një pakoje të konsiderueshme të asistencës teknike për identifikimin e investimeve të mundshme digjitale dhe për të filluar një dialog të rregullt të rregullatorëve të teknologjive, informacionit dhe komunikimit me Komisionin Evropian. Agjenda digjitale për Ballkanin Perëndimor do të lansohet gjatë Asamblesë Digjitale në Sofje, më 26 qershor", ka shkruar Thaçi.






Flet për "Epokën e re", Afrim Hoti

# Samiti i Sofjes, shans i BE-së për B

Profesori i marrëdhënieve ndërkombëtare, Afrim Hoti, ka thënë se për Kosovën është sukses pjesëmarrja në Samitin e Sofjes dhe trajtimi i njëjtë me vendet e tjera. Sipas tij, Kosova është faktor dhe nuk mund të flitet për Ballkanin Perëndimor pa Kosovën, madje edhe në rastet kur disa vende hezitojnë. Hoti ka vlerësuar se ky samit është shans dhe përkushtim i Bashkimit Evropian për vendet e Ballkanit Perëndimor. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se ka një garë në mes të BE-së, Rusisë dhe Turqisë për ta shtrirë ndikimin në Ballkan dhe, sipas Hotit, BE-ja e ka marrë seriozisht këtë sinjal dhe përmes samitit u jep prioritet kushteve që duhet t'i plotësojnë vendet e Ballkanit Perëndimor

## - Pavarësisht prej problemeve të brendshme, BE-ja nuk e ka anashkaluar Kosovën




EPOKA E RE **Shqipe HETEMI**

**Prishtinë, 17 maj** - Profesori i së Drejtës Ndërkombëtare, Afrim Hoti, ka thënë të enjten se Samiti i Sofjes është një shans dhe një përkushtim i Bashkimit Evropian për vendet e Ballkanit Perëndimor. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka theksuar se për Kosovën është sukses pjesëmarrja në këtë samit dhe trajtimi i barabartë me vendet e tjera. "Kjo bëhet edhe më e rëndësishme për faktin se kemi një garë në mes të BE-së, Rusisë dhe Turqisë për ta shtrirë ndikimin në Ballkanin Perëndimor dhe, si duket, BE-ja e ka marrë shumë seriozisht këtë sinjal dhe përmes këtij samiti u jep prioritet detyrave dhe kushteve që duhet t'i plotësojnë vendet e Ballkanit që eventualisht të marrë vendime në samitin e qershorit që pritet të mbahet në Bruksel", ka deklaruar ai. Sipas Hotit, Kosova është faktor dhe nuk mund të flitet për Ballkanin Perëndimor pa Kosovën, madje edhe në raste kur disa vende hezitojnë. "Mendoj se është gjetur një gjuhë e përbashkët, një gjuhë neutrale, sepse deklarata që është nxjerr nga Samiti i Sofjes nuk u atribuohet vendeve, por partnerëve dhe në këtë dritë, si duket, ka qenë edhe një lloj kompromisi që vendet që nuk e kanë njohur Kosovën ta pranojnë lëshimin e deklaratës për të mos i përmendur asnjëherë atributet që janë karakteristika vetëm për shtetet", ka theksuar Hoti.

Ai ka thënë se, pavarësisht prej problemeve të brendshme, BE-ja nuk e ka anashkaluar Kosovën.

Hoti ka shtuar se Kosova ka bërë një hap drejt BE-së, por i mbetet edhe shumë për t'u bërë në këtë rrugëtim. "Para Kosovës dhe liderëve të saj mbesin edhe 700 punë për t'u kryer sepse vetëm me formalitete nuk mund të shkojmë në BE. BE-ja nënkupton plotësim të kushteve të funksionalizimit të shtetit ligjor, luftën e pakompromis kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, ndërtimin e një sistemi gjyqësor efektiv dhe reformën në administratën publike", është shprehur Hoti.

**"Epoka e re":** *Profesor, si e vlerësoni mbajtjen e Samitit të Sofjes ku kanë marrë pjesë liderët e vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe të atyre të Bashkimit Evropian?*

**Hoti:** Samiti i Sofjes është një shans dhe një përkushtim i Bashkimit Evropian për vendet e Ballkanit Perëndimor. Ky është samiti më i rëndësishëm pas Samitit të Selanikut të vitit 2003 që konsiderohet se është hapi më i fuqishëm dhe ngjarja më e rëndësishme që lidhet me këtë pjesë të Evropës. Kjo bëhet edhe më e rëndësishme për faktin se kemi një garë në mes të BE-së, Rusisë dhe Turqisë për ta shtrirë ndikimin në Ballkanin Perëndimor dhe, si duket, BE-ja e ka marrë shumë seriozisht këtë sinjal dhe përmes këtij samiti u jep prioritet detyrave dhe kushteve që duhet t'i plotësojnë vendet e Ballkanit që eventualisht të marrë vendime në samitin e qershorit që pritet të mbahet në Bruksel.

**"Epoka e re":** *Cila është rëndësia kryesore e këtij samiti për Kosovën në veçanti dhe për vendet e tjera në përgjithësi të*

# allkanin Perëndimor



*Ballkanit Perëndimor?*
**Hoti:** Për Kosovën, pa asnjë dilemë, flasim për normalizimin e raporteve me Serbinë, sepse të dy vendet sa më shumë që i ofrohen portës hyrëse në BE duhet të marrin vendime konkrete dhe të dëshmojnë stabilitet e paqe. Përndryshe, me trendin e tanishëm të konfliktit nuk do të ketë BE as për Kosovën e as për Serbinë. Në kontekstin rajonal mendoj se rëndësia e samitit lidhet me rekomandimet që jep BE-ja për ta luftuar krimin dhe korrupsionin në Shqipëri, eventualisht në qershor të miratohet vendimi për fillimin e negociatave të anëtarësimit për Shqipërinë. Maqedonia do ta ketë çështjen e emrit dhe këtu BE-ja e ka bërë të qartë për faktin se tani flitet se cili do të jetë emri i Maqedonisë. Një vëmendje e posaçme do t'i kushtohet edhe konsolidimit të qeverisjes së brendshme në Bosnje Hercegovinë. Këto janë disa nga pikat kyçe të vendeve, por për Kosovën është normalizimi i raporteve me Serbinë. Ky nuk është fundi i stories sepse, përveç aspektit të jashtëm, do të kemi edhe probleme të tjera të brendshme siç është lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, funksionalizimi i Gjykatës Speciale, themelimi i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, reforma në administratën publike dhe çështje të tjera të cilat, nëse jo në samitin e Brukselit, do të jenë çështje shumë të nxehta që do të diskutohen në të ardhmen e afërt për Kosovën.

**"Epoka e re":** *Në këtë samit Kosova në njëfarë mënyre u trajtua si të gjitha vendet e tjera.*
**Hoti:** Deshën apo nuk deshën, u pëlqeu apo jo të tjerëve, Kosova është faktor dhe nuk mund të flitet për Ballkanin Perëndimor pa Kosovën, madje edhe në raste kur disa vende hezitojnë. Mendoj se është gjetur një gjuhë e përbashkët, një gjuhë neutrale, sepse deklarata që është nxjerr nga Samiti i Sofjes nuk u atribuohet vendeve, por partnerëve dhe në këtë dritë, si duket, ka qenë edhe një lloj kompromisi që vendet të cilat nuk e kanë njohur Kosovën, ta pranojnë lëshimin e deklaratës për të mos i përmendur asnjëherë atributet që janë karakteristika vetëm për shtetet. Sido që të jetë, mendoj se për Kosovën është sukses pjesëmarrja në këtë samit dhe dua të besoj se ky sukses do të vazhdojë të trajtohet krejt në mënyrë të barabartë edhe në të ardhmen.

**"Epoka e re":** *Si e komentoni mospjesëmarrjen e kryeministrit të Spanjës në këtë samit për shkak të Kosovës?*
**Hoti:** Kjo çështje fund e krye lidhet me zhvillimet e brendshme në Spanjë dhe ndjeshmërinë që samiti e pjesëmarrja e Kosovës kanë në kontekstin e brendshëm spanjoll që lidhet me rastin e Katalonisë. Kryeministri spanjoll i është bashkuar kampit evropian të shteteve në pjesën e parë, por nuk ka marrë pjesë në seancën formale, duke u përfaqësuar kështu në nivel më të ulët nga ambasadori. Kjo nuk lidhet shumë me Kosovën sa lidhet me zhvillimet e brendshme në Spanjë. Kjo problematikë do të shkrihet me ecjen e mëtejme të Serbisë dhe të Kosovës kah BE-ja, me theks të posaçëm pas nënshkrimit të traktatit me dispozita obliguese, dispozita këto që do ta qartësojnë pozitën e Kosovës dhe të Serbisë. Ky qartësim në mes të dy vendeve do të jetë relaksim edhe për Spanjën dhe vendet e tjera që aktualisht hezitojnë ta njohin Kosovën.

**"Epoka e re":** *Zhvillimet e fundit janë një shpresë se Kosova është duke avancuar drejt BE-së dhe kjo e fundit nuk po e anashkalon?*
**Hoti:** Në konturat e përgjithshme ky është kthim i vëmendjes së BE-së nga Ballkani Perëndimor dhe nuk mund të flitet për Ballkanin pa qenë pjesë edhe Kosova. Shpresat janë të mëdha dhe optimizmi është i madh për faktin se është bërë me dije se nuk ka BE për Kosovën dhe Serbinë pa i rregulluar raportet në mes vete. Këto raporte mendoj se do të rregullohen kur të nënshkruhet traktati me natyrë obliguese për të dyja vendet. Kjo praktikë në të drejtën ndërkombëtare njihet si mënyrë e përfundimit të konfliktit dhe, sipas një rrjedhoje normale, është dashur të ndodhë në vitin 1999, por meqë atëherë nuk ka ndodhur, të paktën nënshkrimi i këtij traktati do ta shënojë fundin formal të konfliktit Serbi - Kosovë dhe njohjen reciproke të të dyja vendeve. Kosova nuk e ka kryer punën, ka bërë vetëm një hap drejt BE-së. Është mirë që BE-ja, pavarësisht prej problemeve të vetat të brendshme, nuk na ka anashkaluar, por e ka trajtuar Kosovën sikurse vendet e tjera. Para Kosovës dhe liderëve të saj mbesin edhe 700 punë për t'u kryer, sepse vetëm me formalitete nuk mund të shkojmë në BE. BE-ja nënkupton plotësim të kushteve të funksionalizimit të shtetit ligjor, luftën e pakompromis kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, ndërtimin e një sistemi gjyqësor efektiv, reformën në administratën publike, vlera këto të cilat do të jenë në majë të agjendës në samitet e radhës apo evenimentet e tjera, pa të cilat Kosova nuk mund të ecë përpara dhe që janë detyrë imediate e institucioneve të vendit tonë.

# Drejtorët e policive rajonale diskutojnë për luftën kundër krimit dhe terrorizmit

EPOKA E RE **Faton DERMAKU**

PRISHTINË, 17 MAJ - Nën organizimin e Policisë së Kosovës, ndihmuar edhe nga EULEX-i, të enjten në Prishtinë ka filluar konferenca rajonale dyditore me drejtorët e policive të shteteve rajonale, të Shqipërisë, Kroacisë, Maqedonisë dhe Sllovenisë. Nikoqir i kësaj konference ka qenë Policia e Kosovës, në krye me ushtruesin e detyrës së drejtorit të përgjithshëm të saj, Naim Rexha.
Pas ditës së parë të konferencës me drejtorët e policive rajonale, ushtruesi i drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Kosovës, Naim Rexha, nëpërmjet një video-deklarate për medie ka thënë se kjo konferencë ka për qëllim shtimin e bashkëpunimit të ndërsjellë rajonal, mbledhjen dhe shkëmbimin e informacioneve në interes të parandalimit të kërcënimeve dhe rreziqeve strategjike siç janë krimi i organizuar ndërkombëtar dhe terrorizmi. "Qëllimi i vetëm i kësaj konference është shkëmbimi i informacioneve të cilat kryesisht kanë të bëjnë me luftimin e formave të rënda të krimit të organizuar, në veçanti atij terrorist", ka thënë Rexha.
Po ashtu, ai ka thënë se kjo konferencë ka rëndësi edhe për Policinë e Kosovës, e cila ende nuk është anëtare e mekanizmave kryesorë të sigurisë. "Kjo konferencë ka rëndësi të veçantë sidomos për Policinë e Kosovës, për faktin e të metës sonë të deritashme, të pamundësisë tonë për të qenë anëtarë të iniciativave themelore të cilat merren me zbatimin e ligjit siç janë Inteproli dhe Europoli", ka deklaruar Rexha, duke shtuar se kjo konferencë i mundëson Policisë së Kosovës të krijojë ura të bashkëpunimit me vendet e rajonit. "Policia e Kosovës insiston të ketë takime dhe bilaterale me policitë rajonale", ka thënë Rexha.
Më tutje, Rexha ka thënë se për luftimin e krimit të organizuar dhe të kriminelëve është i domosdoshëm bashkëpunimi i policive të shteteve rajonale. "Kjo e predikon nevojën tonë që të jemi sa më afër si agjenci të sigurisë dhe zbatimit të ligjit në shtetet përkatëse për të qenë në sukses gjatë harmonisë së veprimeve të përbashkëta që fillojnë prej shkëmbimit të informacioneve e deri te realizimi i operacioneve të përbashkëta policore", është shprehur Rexha.
Në ditën e dytë të kësaj konference, e cila mbahet sot (e premte), është planifikuar një konferencë për medie, në të cilën janë ftuar të marrin pjesë edhe mediet.



# 200 studentë do të angazhohen për punë praktike në institucione

EPOKA E RE Arbisa SHEFKIU



Prishtinë, 17 maj - Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, ka nënshkruar të enjten marrëveshje bashkëpunimi me rektorin e Universitetit të Prishtinës, Marjan Dema, për angazhimin në punë praktike të 200 studentëve për një periudhë tremujore. Reçica ka thënë se në kuadër të bashkëpunimit të mirë me UP-në po konkretizojnë marrëveshjen e cila do të bëjë të mundur angazhimin e 200 studentëve në punë praktike. "Në bashkëpunim me Universitetin e Prishtinës, Agjencinë e Punësimit dhe Qendrat e Aftësimit Profesional, studentëve që kanë përfituar nga kjo marrëveshje u ofrohet një mundësi e mirë që të demonstrojnë edhe në praktikë pjesën teorike të mësuar gjatë studimeve. Bashkëpunimi ynë do të vazhdojë edhe në të ardhmen jo vetëm si një premtim, por edhe në projekte konkrete", ka thënë Reçica. Ai ka shtuar se me qëllim të zbutjes së papunësisë duhet të bashkërendohen aktivitetet dhe të thellohet bashkëpunimi jo vetëm me institucionet relevante publike, por edhe me bizneset, në harmoni me nevojat e tregut të punës.

Me rastin e nënshkrimit të kësaj marrëveshje mori pjesë edhe zëvendëskryeministri Fatmir Limaj, i cili ka pohuar se janë këtu për ta rikonfirmuar mbështetjen për realizimin e objektivave tuaja. Limaj ka çmuar shumë punën e UP-së si në të kaluarën, por edhe tash, duke potencuar se sfida më e rëndë e universitetit është për përgatitjen e kuadrove për shtetndërtimin e Kosovës. "E di që keni vështirësi të mëdha, por ne do t'u qëndrojmë pranë duke ofruar mbështetje, në rend të parë duke forcuar autonominë e UP-së. Qeveritë shkojnë në vijnë e institucionet mbesin. Ne do të vazhdojmë të bashkëpunojmë edhe në të ardhmen. Unë nuk bëj krahasime me të kaluarën, se cila Qeveri ka bërë më shumë apo më pak në këtë drejtim, por ne jemi këtu për të ofruar përkrahje të parezervë për arritjen e qëllimeve tona të përbashkëta", ka thënë Limaj.

Marrëveshjen e ka përshëndetur edhe rektori i UP-së, Marjan Dema, i cili këtë marrëveshje e ka cilësuar shumë të rëndësishme për përgatitjen e studentëve dhe të brezave të rinj që, krahas dijeve teorike, të bëhen pjesë e zhvillimit të Kosovës edhe përmes angazhimit në punë praktike dhe t'u përgjigjen kërkesave dhe nevojave të tregut të punës.

Në ceremoninë e nënshkrimit të marrëveshjes mori pjesë edhe ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi. Ai ka thënë se bashkëpunimi i institucioneve do të vazhdojë edhe në të ardhmen me UP-në duke pasuruar edhe më tutje format e bashkëpunimit. Bytyqi ka premtuar se në të ardhmen e afërt një marrëveshje e tillë me UP-në do të nënshkruhet edhe me MAShT-in.

# Veseli: Djemtë dhe vajzat e Shqiponjës, të parët iu përgjigjen kushtrimit




Shqiponjë, 17 maj (ER) - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, njëherësh kryetar i PDK-së, të enjten ka marrë pjesë në shënimin e përvjetorit të rezistencës kundër makinerisë ushtarake e policore të regjimit serb në fshatin Shqiponjë të Dushkajës. Me këtë rast, kryetari Veseli ka shkruar në llogarinë e vet në "Facebook" se, kur një ditë do të shkruhet historia e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Shqiponja të jetë një faqe e ndritur e saj. "Kur një ditë do të shkruhet historia e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Jabllanica, tash Shqiponja, do të jetë një faqe e ndritur e saj. Djemtë dhe vajzat e Jabllanicës e të rrethinës së Gjakovës ishin ndër të parët që iu përgjigjen kushtrimit që u dha në Prekaz e Gllogjan. Sot ne nderojmë kujtimin e sakrificës së tyre, njëkohësisht zotohemi për vazhdimin e amanetit të tyre, për ta mbrojtur lirinë e fituar me mund e gjak, për ta zhvilluar ekonomikisht vendin, për ta bërë shtetin adresë të sigurt për çdo qytetar të Kosovës", ka shkruar Veseli.

## Ndërron jetë ish-deputeti Kujtim Paçaku



Prishtinë, 17 maj (ER) - Kujtim Paçaku, ish-deputet i Kuvendit të Kosovës nga radhët e komunitetit rom, ka ndërruar jetë të enjten në moshën 59-vjeçare. Paçaku njihej për angazhimin e tij për mbrojtjen e të drejtave të komunitetit rom në Kosovë. Ai lindi në mars të 1959-s në Prizren. Para se të përfshihej në politikë, punoi arsimtar në një shkollë fillore, ndërsa më vonë gazetar, ndërsa ishte i njohur si poet. Së fundmi Paçaku ishte shpallur ambasador i paqes në një konferencë për kulturën dhe paqen në Ballkan.

Duke dhënë lajmin për vdekjen e Paçakut, kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka thënë se me angazhimin e tij të sinqertë politik, me kulturën e pasur prej poeti që kishte, Kujtimi ishte zëri më autentik i qytetarëve romë të Kosovës.

Sot (e premte) në orën 11:00 në Teatrin e Prizrenit "Bekim Fehmiu" do të mbahet mbledhje komemorative, ndërsa në orën 13:00 do të bëhet varrimi i tij në varrezat e Prizrenit.

# Kuvendi miraton Projektligjin për mësimdhënësit e viteve '90



EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 17 MAJ - Me 71 vota për, 1 kundër dhe 2 abstenime, Kuvendi i Kosovës ka miratuar në lexim të parë Projektligjin për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Kosovës nga viti shkollor 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99. Projektligji ka të bëjë me njohjen dhe përcaktimin e të drejtave të përfitimeve të punëtorëve të arsimit shqip që punuam në vitin shkollor '90/'91 dhe '98/'99.

Para se të votohet ky projektligj nga deputetët, ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyçi, e ka quajtur këtë projektligj të një rëndësie të veçantë. "Qëllimi i nxjerrjes së këtij projektligji është njohja dhe përcaktimi i të drejtave të punëtorëve të arsimit shqip të Kosovës që punuan nga viti shkollor 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99", ka thënë Bytyçi.

Ndërsa ministri i Financave, Bedri Hamza, ka thënë se me vëmendje e ka ndjekur debatin për punonjësit e arsimit dhe ka vlerësuar lart kontributin e punonjësve të arsimit.

Kuvendi i Kosovës nuk e ka miratuar vendimin e presidentit Hashim Thaçi për kthimin e Ligjit për shoqëritë tregtare, pasi 28 deputetë kanë votuar për, 32 kundër, 7 kanë abstenuar. Me mosmiratimin e vendimit të presidentit, projektligji mbetet ashtu siç është miratuar me amendamentin, i cili parasheh kuotën për bizneset që në bordet e tyre udhëheqëse të kenë 40 për qind gra.

Deputetja e cila ka propozuar amendamentet që obligojnë shoqëritë tregtare të kenë 40 për qind femra në bordet udhëheqëse, Mimoza Kusari-Lila, ka thënë se argumentet e presidentit nuk janë të qëndrueshme. Në emër të grupit parlamentar të PDK-së ka folur Memli Krasniqi, i cili është shprehur kundër këtij amendamenti të propozuar nga deputetja Kusari-Lila. "Në emër të PDK-së ju njoftoj se do ta mbështesim rekomandimin e presidentit që, në fakt, është rekomandim i komisionit sepse, siç e parasheh Kushtetuta, komisioni i ka dhënë mbështetje këtij rekomandimi. Ky amendament nuk e ka në fokus fuqizimin e grave në bizneset e Kosovës. Është një tendencë për të imponuar vendime në biznesin privat. Nuk e ndihmon funksionimin e lirshëm të biznesit në Kosovë dhe, si i tillë, do të duhej të votohej rekomandimi i komisionit, kurse amendamenti i Mimoza Kusarit të hiqej nga projektligji", është shprehur Krasniqi. Po në këtë seancë me 74 vota për Kuvendi i Kosovës ka miratuar në lexim të dytë projektligjin për mbrojtjen e konsumatorit.

## Miratohet Ligji për Prishtinën, Prizreni kryeqytet historik

Me 66 vota për, 1 abstenim, deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë votuar Projektligjin për Prishtinën. Në shqyrtimin e dytë të këtij Projektligjit u ngjall një debat për amendamentin numër dy të këtij projektligji, i cili përcakton kryeqytet të Kosovës Prishtinën, ndërsa Prizrenin kryeqytet historik të Kosovës. Edhe pse pati kundërshtime për amendamentin numër dy nga deputetët e LDK-së, me shumicë votash Prizreni me këtë projektligj mbetet kryeqytet historik.

# Pagesat e policës kufitare bëhen 'online'



EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 17 MAJ - Pas punës intensive të iniciuar nga Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike, në pikëkalimin kufitar Merdar, të enjten zëvendëskryeministri dhe ministri i Diasporës dhe Investimeve Strategjike, Dardan Gashi, ka lansuar edhe zyrtarisht softuerin e pagesave "online" të policave të sigurimit kufitar për bashkatdhetarët tanë.

Ministri Gashi, i shoqëruar edhe nga ministri i Punëve të Brendshme, Bejtush Gashi, drejtori i policisë kufitare, Shaban Guda, dhe zyrtarët e BKS-së, ka vlerësuar rëndësinë e madhe të këtij projekti. "Duke u kryer pagesat online do të eliminohen edhe pritjet e mërgimtarëve në kufi. Kjo ditë është e veçantë sepse lansojmë softuerin për pagesën e policave 'online'. Me këtë bashkatdhetarëve do t'u lehtësohet në mënyrë drastike hyrja në Kosovë. Më nuk do të krijohen radhë të gjatë, por pagesa do të mund të bëhet në mënyrë elektronike 'online'", ka thënë Gashi.

Ai ka theksuar se po punohet për heqjen e tërësishme të kësaj pagese.

Gashi ka falënderuar në veçanti edhe ish-ministrin e Brendshëm, Flamur Sefaj, i cili ka punuar intensivisht për jetësimin e këtij projekti të rëndësishëm. Edhe ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme, Bejtush Gashi, ka përgëzuar fillimin e këtij projekti, i cili në masë të madhe do t'i lehtësojë procedurat e kalimit në pikat kufitare. Ky sistem do të jetë funksional në të gjitha pikat kufitare. Për çdo informacion lidhur me policën e sigurisë bashkatdhetarët do të mund të informohen në detaje në Byronë Kosovare të Sigurimeve.

## Bie numri i rasteve të fruthit në Kosovë



PRISHTINË, 17 MAJ (ER) - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike (IKShP) ka njoftuar se gjatë mbikëqyrjes permanente të sëmundjeve ngjitëse në Kosovë ka rënë numri i rasteve me fruth në Kosovë. Sipas të dhënave të sistemit të mbikëqyrjes së fruthit në Kosovë për periudhën 1 mars 2017 deri më 15 maj 2018 janë raportuar 929 raste të dyshuara në fruth, prej të cilëve në laboratorët e IKShP-së janë konfirmuar 679 raste pozitive. Numri më i lartë i rasteve është nga Komuna e Fushë-Kosovës me 198 raste, e përcjellë nga Komuna e Prishtinës me 145 raste të konfirmuara. Në Klinikën Infektive gjatë 24 orëve të fundit nuk është raportuar asnjë rast i ri i dyshuar në fruth, ku aktualisht janë të hospitalizuar tre pacientë të dyshuar me fruth. Kosova radhitet në mesin e vendeve me përqindje të lartë të vaksinimit kundër fruthit.

# Mbahet takimi MBPZhR-KE, bujqësia do të jetë prioritet strategjik



Prishtinë, 17 maj (ER) - Në kuadër të takimeve të rregullta të Qeverisë së Kosovës dhe Komisionit Evropian, të enjten është mbajtur takimi i tyre i dytë sektorial në mes të përfaqësuesve të KE-së, përkatësisht Nënkomitetit të MSA-së për Bujqësi, Sigurisë Ushqimore dhe Peshkatari dhe Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Në këtë takim, i cili mbahet në kuadër të kornizës së Dialogut për Procesin e Stabilizim Asociimit (DPSA), sekretari i përgjithshëm i MBPZhR-së, Kapllan Halimi, ka thënë se bujqësia është një prej sektorëve kyç në ekonominë e vendit. "Qeveria e Kosovës e ka vendosur bujqësinë si prioritet strategjik të zhvillimit kombëtar të vendit, e cila zë vend të rëndësishëm në planin e politikave ekonomike evropiane. Ne si institucion kemi bërë përpjekje të vazhdueshme që të gjeturat e vitit të kaluar t'i adresojmë në planin tonë vjetor të punës. Këtë vit jemi fokusuar në hartimin e legjislacionit, në harmoni me politikat e përbashkëta bujqësore të BE-së, si dhe jemi munduar për ngritjen e kapaciteteve profesionale të zyrtarëve të institucionit tonë, pasi niveli i kënaqshëm i kompetencës së tyre do të sjellë edhe produktivitet dhe cilësi në vazhdën e punës", ka thënë Halimi.

Ndërsa përfaqësuesja e KE-së, njëherësh edhe zëvendësshefe e Fqinjësisë Evropiane në Negociatat e Zgjerimit në Komisionin Evropian, Mary Teresa, u shpreh e kënaqur lidhur me raportin dhe detajet e përfshira në të dhe në të gjitha përpjekjet e zyrtarëve të MBPZhR-së për të arritur sukses në rekomandimet e vitit paraprak. Tema e parë e cila u përzgjedh si prioritet i diskutimit në këtë takim ishte rreth sigurisë ushqimore në vend.

Mbahet takimi MBPZhR-KE, bujqësia do të jetë prioritet strategjik



Prishtinë, 17 maj (ER) - Në kuadër të takimeve të rregullta të Qeverisë së Kosovës dhe Komisionit Evropian, të enjten është mbajtur takimi i tyre i dytë sektorial në mes të përfaqësuesve të KE-së, përkatësisht Nënkomitetit të MSA-së për Bujqësi, Sigurisë Ushqimore dhe Peshkatari dhe Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Në këtë takim, i cili mbahet në kuadër të kornizës së Dialogut për Procesin e Stabilizim Asociimit (DPSA), sekretari i përgjithshëm i MBPZhR-së, Kapllan Halimi, ka thënë se bujqësia është një prej sektorëve kyç në ekonominë e vendit. "Qeveria e Kosovës e ka vendosur bujqësinë si prioritet strategjik të zhvillimit kombëtar të vendit, e cila zë vend të rëndësishëm në planin e politikave ekonomike evropiane. Ne si institucion kemi bërë përpjekje të vazhdueshme që të gjeturat e vitit të kaluar t'i adresojmë në planin tonë vjetor të punës. Këtë vit jemi fokusuar në hartimin e legjislacionit, në harmoni me politikat e përbashkëta bujqësore të BE-së, si dhe jemi munduar për ngritjen e kapaciteteve profesionale të zyrtarëve të institucionit tonë, pasi niveli i kënaqshëm i kompetencës së tyre do të sjellë edhe produktivitet dhe cilësi në vazhdën e punës", ka thënë Halimi.

Ndërsa përfaqësuesja e KE-së, njëherësh edhe zëvendësshefe e Fqinjësisë Evropiane në Negociatat e Zgjerimit në Komisionin Evropian, Mary Teresa, u shpreh e kënaqur lidhur me raportin dhe detajet e përfshira në të dhe në të gjitha përpjekjet e zyrtarëve të MBPZhR-së për të arritur sukses në rekomandimet e vitit paraprak. Tema e parë e cila u përzgjedh si prioritet i diskutimit në këtë takim ishte rreth sigurisë ushqimore në vend.

# Numri i madh i veturave të paregjistruara, shqetësues

Prishtinë, 17 maj (ER) - Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme, Bejtush Gashi, ka pritur të enjten në takim guvernatorin e Bankës Qendrore të Kosovës, Fehmi Mehmeti, me të cilin ka diskutuar për kartonin e gjelbër. Të dy bashkëbiseduesit vlerësuan se problem shqetësues mbetet numri i madh i



veturave të paregjistruara, të cilat, ndër të tjera, paraqesin problem serioz për Republikën e Kosovës sa i përket anëtarësimit në kartonin e gjelbër. Me këtë rast, ministri Gashi ka theksuar se është duke gjetur modalitete më të përshtatshme për ta zgjidhur problematikën e veturave të paregjistruara, të cilat, përveç të tjerash, paraqesin rrezik edhe për sigurinë në trafik. Po ashtu, u diskutuan edhe modalitetet e bashkëpunimit në mes të MPB-së dhe BQK-së, në projekte që përfshijnë të dy institucionet, me qëllim të ofrimit të shërbimeve sa më të mira për qytetarët e Republikës së Kosovës.

# Lansohet fondi për inovacion dhe ndërmarrësi për organizatat joqeveritare



Ministri i Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Besim Beqaj, ka bërë me dije se fondi do t'i ketë tri nivele të mbështetjes financiare, nga 15 000 deri në 200 000 euro. Beqaj ka theksuar se vizioni i Ministrisë së Inovacionit është që rininë ta bëjë faktorin kryesor për rritje të konkurrueshmërisë në vend dhe ta përkrahë atë sektor që shënon bilancin pozitiv tregtar

A. MAVRAJ

**Prishtinë, 16 maj** - Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë ka lansuar të enjten "Programin për financim të inovacionit dhe ndërmarrësisë" për organizatat joqeveritare. Ky program/fond do t'i mbështesë financiarisht projektet e OJQ-ve që kanë për qëllim zhvillimin dhe promovimin e inovacionit dhe ndërmarrësisë në Republikën e Kosovës. Në hapje të kësaj ngjarjeje para pjesëmarrësve ka folur ministri i Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Besim Beqaj. Ai ka theksuar rëndësinë që ka lansimi i këtij programi për promovim dhe zhvillim të inovacionit nga OJQ-të, duke theksuar se ministria që drejton, në bashkëpunim me organizatat me kredibilitet ndërkombëtar, do të bëjë që procesi i ndarjes së fondeve të jetë transparent dhe me efekt të prekshëm ekonomik për vendin. "Kjo është ngjarja më e rëndësishme që nga themelimi i Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë. Vizioni i Ministrisë së Inovacionit është që rininë ta bëjë faktorin kryesor për rritje të konkurrueshmërisë në vend dhe ta përkrahë sektorin i cili po shënon bilancin pozitiv tregtar", ka thënë Beqaj.

Më tutje, Beqaj ka specifikuar edhe kategoritë e përfituesve të fondeve, duke theksuar se programi do t'i ketë tri nivele të mbështetjes financiare, nga 15 000 deri në 200 000 euro. "Niveli i parë është përkrahje financiare deri në 15 000 euro, i cili nënkupton OJQ të reja që fokusohen në inovacion, pra nuk do t'i marrin këto mjete për vete, por do t'i marrin për t'i transformuar në njohuri, në dije, i cili mund të ketë ndikim në efekte ekonomike. Niveli i dytë shkon deri në 50 000 euro dhe ka të bëjë me OJQ-të të cilat kanë përvojë, që kanë regjistër të sukseseve të tyre dhe normalisht ato kanë edhe kushte specifike, që të kenë njerëz dhe të sjellin argumente që kanë pasur përvojë në këtë lëmë. Ndërsa niveli i tretë është ai i cili konsiderohet se do t'i vihet në shfrytëzim ekonomisë së ndërmarrjeve të vogla përmes programeve trajnuese në fushën e inovacionit dhe ndërmarrësisë. Për nivelin e financimit prej 200 000 eurosh janë të ftuara ndërmarrjet që kanë përvojë në trajnime dhe prezantimin e ideve të tyre", ka bërë me dije ministri Beqaj. Ai është shprehur i sigurt se ky program do të sjellë përfitime për zhvillim ekomomik të vendit. "Programi për përkrahjen financiare të OJQ-ve, që fushë të veprimtarisë e kanë inovacionin dhe ndërmarrësinë, është hap i rëndësishëm që po bën sot MIN në drejtim të hapjes së mundësive për shfrytëzim të potencialit të të rinjve të Kosovës në fushën e teknologjisë informative", ka thënë Beqaj.

Në ceremoninë e lansimit të Fondit për Inovacion dhe Ndërmarrësi për OJQ-të, para pjesëmarrësve kanë folur edhe zëvendësministri i Ministrisë së Financave, Fatmir Gashi, drejtoresha e STIKK-ut, Vjollca Çavolli dhe Arianit Dobroshi nga "Prishtina Hackerspace".

## Dogana kap mbi pesë kilogramë marijuanë



**Prishtinë, 17 maj (ER)** - Mbrëmjen e së mërkurës oficerët doganorë në hyrje të Vërmicës kanë kapur pesë qese të dyshuara me substancë narkotike marijuanë. Ata kanë ndaluar një automjet të llojit 'Golf V', ngjyrë të zezë, me targa të Kosovës. Gjatë kontrollit të automjetit në ulëset e pasme është hasur në dy çanta ku janë gjetur pesë qese të dyshuara me substancë narkotike marijuanë. Gjatë kontrollit të detajuar është përcaktuar pesha e kësaj substance narkotike që është rreth 5.335 kg. Rasti është përcjell tek Policia e Kosovës, së cilës i është dorëzuar substanca e dyshuar.

# Arrestohen katër persona në veri të Mitrovicës

MITROVICË, 17 MAJ - Policia e Kosovës ka arrestuar katër persona në veri të Mitrovicës. Në mesin e të arrestuarve janë tre meshkuj dhe një femër. Aksioni i Policisë së Kosovës ka filluar në orët e mëngjesit të së enjtes, i cili është zhvilluar në tri lokacione të ndara në veri.
Zëvendëskomandanti i Policisë së Kosovës për rajonin e Mitrovicës, Besim Hoti, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se gjatë bastisjes është gjetur një revole si dhe dëshmi të tjera. "Bastisjet janë kryer me urdhëresë të gjykatës në dy lokacione në veri të Mitrovicës dhe një tjetër në një fshat të Komunës së Zveçanit. Operacioni i kontrollit është ndërmarrë pas disa rasteve serioze të ndodhura kohët e fundit në veri të vendit", ka thënë Hoti. Sipas Hotit, me vendim të prokurorit personave të arrestuar u është caktuar ndalimi policor për 48 orë.





# Pacolli: Prishtina ka nevojë për mbështetje të projekteve infrastrukturore

PRISHTINË, 16 MAJ (ER) - Zëvendësministri i Infrastrukturës (MI), Rexhep Kadriu, ka pritur në takim një delegacion nga komuna e Prishtinës, i kryesuar nga nënkryetari i kësaj komune, Selim Pacolli. Në këtë takim Kadriu e Pacolli kanë biseduar për projektet infrastrukturore që janë duke u realizuar nga dy nivelet e qeverisjes, të cilat kanë ndikim të madh në dinamikën e jetës së qytetarëve të kryeqytetit, sidomos në qarkullimin e lirë. Fillimisht zëvendësministri Kadriu ka thënë se bashkëpunimi i MI-së me Komunën e Prishtinës është në funksion të harmonizimit të projekteve.
Ai ka premtuar se Ministria e Infrastrukturës do ta mbështesë Komunën e Prishtinës për aq sa lejojnë mundësitë buxhetore. "Sot po bisedojmë për zgjerimin e 'Veternikut', kyçja e rrugës 'A', me nënkalimin që i lidhë dy lagjet, atë 'Kalabria' me pjesën tjetër të qytetit, unazën e brendshme dhe tri projekte të tjera që do ta lidhin Prishtinën me zonat rurale", ka thënë zëvendësministri Kadriu.
Ndërsa nënkryetari i Komunës së Prishtinës, Selim Pacolli, ka thënë se kryeqyteti ka nevojë për mbështetje në projektet e mëdha infrastrukturore. Në këtë kontekst, Pacolli ka thënë se kjo komunë do të jetë e hapur për bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës, në mënyrë që projektet infrastrukturore të jenë të harmonizuara ndërmjet vete.



# Rivendosen 'policët e shtrirë' në Kodrën e Trimave

PRISHTINË, 17 MAJ (ER) - Kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, ka bërë me dije se sinjalizimi në këtë komunë po bëhet sipas prioriteteve dhe statistikave të vitit të kaluar, duke i rivendosur "policët e shtrirë" në Kodrën e Trimave. "Së shpejti Komuna e Prishtinës do të fillojë kamera në komunikacion dhe dënime me postë", ka thënë Ahmeti.

# Rrugët që paraqesin rrezik në Prishtinë

PRISHTINË, 17 MAJ (ER) - Të prishura, të pashtruara, me urë të dëmtuar, janë disa rrugë të Prishtinës. Këto rrugë rezultojnë të jenë në këtë gjendje me muaj të tërë dhe paraqesin rrezik për vozitësit. Në shumë rrugë të Prishtinës ka pika të konfliktit, në të cilat ndodhin edhe aksidente të shpeshta. Duke qenë kështu, studentët e Fakultetit të Inxhinierisë Ndërtimore dhe Infrastrukturës, të specializimit Komunikacion dhe Infrastrukturë në UBT, kanë vizituar këto rrugë. "Si vend të rrezikshëm për qarkullim të automjeteve të transportit të mallrave është konsideruar rruga nacionale N2 si dhe rruga regjionale Fushë Kosovë - Prishtinë. Nga studentët doli ky përfundim pasi që lartësia e automjeteve është mbi 4.50 m, ndërsa ura shihet qartë se është e dëmtuar. Kjo rrugë i plotëson kushtet të konsiderohet një vend i rrezikshëm për shkak të ngarkesës së rrugës, formës gjeometrike të saj dhe kaheve të lëvizjes së automjeteve", është bërë me dije në njoftimin e Kolegjit UBT.
Më tej në njoftim thuhet se një vend i tillë, i konsideruar i rrezikshëm, është edhe kryqëzimi i rrugës "Agim Ramadani" dhe "Fehmi Lladrovci" afër Fakultetit Teknik. "Në ketë kryqëzim të rrugës fazat në semaforë krijojnë pikë konflikti që, në realitet, e shndërron këtë kryqëzim të rrugës në një vend të rrezikshëm", është theksuar në njoftimin e UBT-së.
Vizita studimore në rrugët e Prishtinës është realizuar në mënyrë që studentët t'i shohin problemet në praktikë dhe të mësohen t'i identifikojnë pikat e konfliktit, të cilat paraqesin rrezikshmëri të lartë për drejtuesit e automjeteve, por edhe të merren masat parandaluese për eliminimin e këtyre vendeve të rrezikshme përmes metodës "Dritarja e rrëshqitshme", duke marrë një segment rrugor në gjatësi prej 300 metrash, ku kanë ndodhur dy e më shumë aksidente.



Nga shkolla kombëtare e Prekazit për progres kombëtar deri në liri, vlera historike dhe filozofike-kombëtare e luftës së UÇK-së 1991-1999 nuk bën të nëpërkëmbet (7)

# Nuk guxojmë t'i koritim miqtë që kanë investuar në lirinë dhe sovranitetin tonë



Prof. dr. Hakif BAJRAMI

Në këtë rrafsh, një fakt është edhe më brengosës. Ne nuk guxojmë, me anarkinë që po dëshmohet ngadalë, t'i koritim miqtë që kanë investuar në lirinë dhe sovranitetin tonë të kontrolluar. Pse është ky kontrollim, sepse lufta e UÇK-së është sabotuar publikisht, është luftuar deri në skajshmëri. Faktet janë të hidhura. Kam pasur urdhër nga bacë Adem Demaçi, të shkoj në çdo institucion dhe t'i ftoj: Po ju thërret zëri i atdheut në luftën çlirimtare. Në atë mision e kam pasur përkrah edhe atdhetarin Osman Dumoshi. Por jo more, nuk kemi qenë të përcaktuar të flijohemi për liri. E tani shumëkush po mbështetet në Epopenë e Adem Jasharit, por ani disi le të thirren, nuk është vonë, po shumëçka është për paradë dhe me hile. Ja, këtu është embrioni i infektimit të nivelit ku kemi ardhur.

Ne nuk guxojmë t'i koritim miqtë e shtrenjtë, sidomos ShBA, që kanë investuar në lirinë tonë. Jo, këtë zakon më e shkelë bukën e mikut, nuk e kemi pasur kurrë në histori. Pse ta krijojmë një zakon të keq, e besa jemi shumë afër krijimit me këta politikanë bastardë dhe bukëpërmbysët, që disi po punojnë për idealet e Rusisë pansllaviste dhe Serbisë neofashiste. Mblidhni mend politikanë, të zhytur në lakmi dhe profite që sjellë pushteti, në inate primitive.

Jo, sjelljet e pushtetit ndaj deputetëve më 19 shkurt 2016 në Parlamentin e Kosovës, ua tejkalojnë sjelljeve të udbashëve më 1981, ndaj patriotëve demonstrues. Këta drejtues të policisë t i thyejnë brinjët sepse nuk kanë nivel tjetër të dëshmohen në injorancë dhe jo profesionalizëm. E vërteta, policia po e kryen profesionalisht punën, por urdhrat janë kriminale dhe anticivilizuese. Ka metoda tjera, ato literatura historike shkencore i ka të elaborura. Ky fakt dhe kjo psikologji, që ka nxënë pozicion në pushtetin e kësaj qeverie duhet të analizohet prej psikologëve, sociologëve, historianëve, juristëve, pedagogëve, filozofëve. Kjo sjellje është kanceroze për të dy palët: pozitë dhe opozitë. Si ta doni merreni, kupa është mbushur. Dhe rrugëdalja duhet të gjendet nga kokat e ftohta dhe të nivelit të lartë intelektual, shkollor dhe zakonor popullativ.

Lehtë është të kritikosh por duhet ofruar zgjidhje përfundimtare. E zgjidhja nuk është çështje e mendimit të një individi, por mbetet çështje ekipore profesionale dhe besa edhe shkencore, gjithnjë duke e humanizuar shoqërinë, shtetin në dobi të civilizimit. Prova të shtetit të dhunës kemi për inflacion dhe shumë mirë të njohura. E pra, mos të përsëritet histori tragjike. Këtë të paktë nuk e meriton populli dhe miqtë që na përkrahin. Kjo thirrje nuk është moralizim ,por dashuri dhe brengosje për Kosovën.

Në këto rrethana që është sjell Kosova, duhet të pyetet publikisht LDK-ja dhe Vetëvendosja, pse nuk kemi ushtrinë e themeluar, forca e së cilës sot do të ishte një garanci i sigurt, se kombi dhe shteti më i ri dhe më i izoluar në Evropë me dhe pa fajin tonë nuk mund të jetë i sigurt pa ushtri. Tek e fundit çdo investitor së pari pyet këtu a ka siguri. Në investimet ekonom ike nuk ka fort patriotizëm. Opinioni evropian dhe ai i ShBA-ve do të kishte këtë pyetje, pse minoriteti serb në Kosovë edhe sot është njëfarë rreziku që kërkon publikisht (jo të gjithë) Serbia të kthehet në Kosovë, sepse "shqiptarët e shihni çfarë janë, nuk dinë të krijojnë shtet, janë përçarë ne mes veti e çka do të bëjnë me neve pastaj po u pavarësuan"? Ngrihu e ndalojua gojën me këtë hallakamë kudo. Por, kur shtrohet kjo pyetje, duhet të gjendet përgjigja se kush ua ka "përkujtuar" serbëve të Kosovës dhe të Serbisë shansin, që ka mundësi të kthehet e vjetra dhe e dënuara gjenocidale, kur shqiptarët përgatitën për luftë qytetare!!!?. Padyshim se në këtë përgjigje më së shumti ka hise Mati Ahtisari, me Kushtetutën e caktuar dhe të kurdisur si një bombë me sahat. Këtë bombë me sahat, tani pas përçarjeve të skajshme në Kosovë e ka në dorë detonatorin Rusia, Ahtisari dhe Grupi i Kontaktit - Quintit të sotshëm që duhet të pyetet pse çdo fshat serb u kthye në komunë dhe pse pas çdo paraqitje të Kosovës në arenën ndërkombëtare, diplomacia serbe ka siguruar fusnotë ku figuron numri 1244 rezoluta e OKB-së. Pas këtyre pyetjeve jepet shpjegimi se 5% e serbëve disponon me 25% të territorit Kosovës, njëjtë sikurse në Bosnje 31% popull e 49% territor. Ky fakt synohet të arrihet në Kosovë. Dhe pse politikanët shqiptar lejojnë së të kërkohet nga zërat meskin dhe tradhtar që Ambasadori i ShBA-ve, të shpallet person i padëshiruar në Kosovë. Ky sulm në mikun më të madh të kombit, sigurisht se vjen nga qarqet kontrainformative tradhtare dhe antishqiptare, por kombi nuk e ka parë as në ëndërr. E pra politikanë, mos shihni ëndrra me sy qelë në përçarje se pse okupatori nuk po fle, sepse rruga po u humbë në oborr juve të gjithëve në pikë të ditës. Rruga u është bërë natë nëse e humbasin fronin, prandaj edhe keni filluar të trilloni çka jo e si jo.

Ndaleni turrin të gjithë politikanët shqiptarë, sepse shembulli, me dorëheqje dinjitoze ka treguar se ky komb do të mbijetojë dhe triumfojë para çdo stuhie që e fabrikoni. Mblidhni i mend pushtetarë, të gjithëve u drejtohem! **(Fund)**

# Në Mitrovicë mbahet manifestimi tradicional 'Festa e Abetares'

**Prishtinë, 17 maj (ER)** - Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (MAShT) për herë të nëntë ka organizuar manifestimin mbarëkombëtar "Festa e Abetares", i cili këtë vit është mbajtur në Mitrovicë, në të cilin kanë marrë pjesë përfaqësues nga Kosova, Shqipëria dhe Presheva, të cilët kanë prezantuar me programe kulturore-artistike, të realizuara nga nxënësit e klasave të para.

Zëvendësministri i Arsimit, Heset Sahiti, me këtë rast ka uruar nxënësit, mësimdhënësit dhe prindërit për arritjet dhe përmbylljen me sukses të punës njëvjeçare të fatosave. Ai ka theksuar se ky manifestim është një festë e madhe për të gjithë sepse një gjeneratë e tërë po e fillon udhëtimin e tyre shtigjeve të dijes. "Festa e Abetares është një festë jo vetëm e fëmijëve që sot e përmbyllin me sukses mësimin e shkronjave të gjuhës shqipe, jo vetëm për mësueset dhe mësuesit të cilët e kurorëzojnë sot punën e tyre njëvjeçare me nxënësit e tyre. Është një festë për




prindërit që i gëzohen përfitimit të shkathtësive jetike të fëmijëve të tyre, shkrim-leximit", është shprehur zëvendësministri Sahiti. Ai ka thënë se këta fëmijë të cilët sot dinë të shkruajnë dhe të lexojnë, janë brezi që do të zhvillojë dhe ndërtojë të ardhmen tonë të ndritur, ndërsa rikujtoi rilindësit dhe intelektualët të cilët hartuan abetaret e para në gjuhën shqipe. Zëvendësministri ka ndarë mirënjohje për shkollat pjesëmarrëse dhe për koordinatorët regjionalë. Festa e Abetares ka për qëllim ta zgjojë kureshtjen te fëmijët për angazhime në aktivitete të ndryshme kulturore-artistike, të zhvillojë shkathtësi për punë në grupe, ta mësojë respektimin e rregullave në shfaqje publike dhe ta ngrehë vetëdijen për vlerën që ka Abetarja si tekst mësimor.

## Juncker: BE-ja do t'i nisë masat për t'i bllokuar sanksionet e ShBA-së kundër Iranit



Sofje, 17 maj - Komisioni Evropian do ta nisë procesin e aktivizimit të ligjit që u ndalon kompanive evropiane t'i zbatojnë sanksionet e Shteteve të Bashkuara të Amerikës kundër Iranit dhe i cili nuk njeh masat ndëshkuese ndaj tyre. "Si Komision Evropian ne kemi për detyrë t'i mbrojmë kompanitë evropiane. Tani duhet të veprojmë dhe për këtë arsye po fillojmë procesin e aktivizimit të statutit bllokues nga viti 1996", ka thënë Jean-Claude Juncker. "Gjithashtu, kemi vendosur të lejojmë që Banka Evropiane e Investimeve të ndihmojë në investimet e kompanive evropiane në Iran. Komisioni do ta vazhdojë bashkëpunimin me Iranin", tha Junckeri në një konferencë me gazetarë pas një takimi të liderëve të BE-së.
Masat e BE-së pasojnë vendimin e presidentit amerikan Donald Trump në lidhje me marrëveshjen bërthamore me Iranin.

# Kompanitë evropiane do të largohen nga Irani nëse rrezikohen nga sanksionet e ShBA-së

Departamenti amerikan i Thesarit ka njoftuar se kompanitë kanë gjashtë muaj kohë për t'i ndalur aktivitetet e tyre në Teheran para se të përballen me sanksione të ashpra

Bruksel, 17 maj - Gjiganti francez i energjisë, Total, u është bashkuar kompanive të mëdha evropiane të cilat kanë deklaruar se do të largohen nga Irani në rast se do të preken nga sanksionet amerikane. Liderët evropianë në Samitin e Sofjes kanë treguar edhe një herë përkushtimin e tyre më 16 maj për ta ruajtur marrëveshjen bërthamore të vitit 2015, që Teherani ka me fuqitë botërore. Mirëpo njoftimi i kompanisë Total dhe kompanive të tjera gjermane e daneze më herët gjatë kësaj jave tregon vështirësitë me të cilat përballen shtetet evropiane për ta ruajtur marrëveshjen, pas tërheqjes së ShBA-së.
Total ka thënë se do të largohet nga projekti një miliard dollarësh për zhvillimin e fushës së gazit Parsi Jugor, përveç rastit kur do të bëhej ndonjë përjashtim dhe nuk do t'i vendoseshin sanksione amerikane, sipas vendimit të presidentit amerikan Donald Trump.
Teherani në vazhdimësi ka përmendur projektin e kompanisë Total si simbol të paktit bërthamor duke ndihmuar në modernizimin e industrisë së naftës dhe gazit në Iran. Total ka qenë kompania e parë e madhe evropiane që është kthyer për të bërë biznes në Iran, pas largimit të sanksioneve më 2016, meqë Teherani ishte zotuar për frenim të aktiviteteve bërthamore.
Tërheqja e kësaj kompanie do të përbënte goditje për presidentin iranian, Hassan Rohani, i cili ka shpresuar se ky projekt do të ndihmonte që edhe kompani të tjera t'i nisnin investimet në Iran. Deri më tash Teherani nuk ka



komentuar njoftimin e kompanisë Total.
Deklarata e kompanisë franceze ka pasuar një varg njoftimesh të tilla nga biznese evropiane, të cilat kanë reaguar pasi Departamenti Amerikan i Thesarit ka njoftuar se kompanitë kanë gjashtë muaj kohë për ndalur t'i aktivitetet e tyre në Teheran para se të përballen me sanksione të ashpra.
Në të kaluarën Shtetet e Bashkuara kanë gjobitur banka dhe biznese evropiane dhe aziatike për shkelje të sanksioneve.
Sanksionet amerikane kërkojnë nga kompanitë globale të heqin dorë nga të bërit biznes në Iran nëse dëshirojnë të operojnë në ShBA.
Liderët e 28 vendeve anëtare në BE që janë takuar në Sofje nuk kanë marrë ndonjë vendim të shpejtë për atë se si t'i ruajnë bizneset evropiane që janë aktive në Iran.
Presidenti i Komisionit Evropian, Jean-Claude Juncker, ka prezantuar disa mundësi si mund të ruhen investimet evropiane, duke përfshirë sanksione hakmarrëse.
Irani u ka kërkuar liderëve evropianë të "garantojnë" se do t'i vazhdojnë përfitimet ekonomike të marrëveshjes, mirëpo shefja e Politikës së Jashtme në BE, Federica Mogherini, ka thënë se një gjë e tillë është vështirë e realizueshme. Mirëpo ajo ka thënë se BE-ja do të shqyrtojë çdo mundësi për të mbajtur raporte biznesore me Teheranin dhe t'i lejojë atij të shesë naftë në gjithë botën.
Zyrtari i lartë evropian për energji, komisionari Miguel Arias Canete, do ta vizitojë Iranin nga 18-21 maj për të diskutuar mënyrën se si mund të tejkalohen sanksionet amerikane në industrinë e naftës së Iranit.
Ministri iranian i Naftës, Bijan Zanganeh, ka thënë në anën tjetër se Teherani do të mbijetojë nga sanksionet e reja. "Situata momentale do të kalojë dhe Irani do të jetë fitues", është cituar të këtë thënë ai sipas agjencisë së lajmeve SHANA.

# FBI-ja e shqetësuar për terrorizmin brenda SHBA-së

Romë, 17 maj - Lidhur me hetimet mbi terrorizmin në territorin amerikan, shefi i FBI-së, Christopher Wray, deklaroi se Byroja Federale e Hetimeve ka nën hetim rreth 1 000 çështje për të ashtuquajturit "ujqërit e vetmuar", thënë ndryshe terroristë që veprojnë të vetëm. "Ky fenomen është shtrirë në të 50 shtetet e ShBA-së", shtoi ai. "Kemi nën vëzhgim edhe 1 000 të tjerë, të quajtur ndryshe 'terroristë të brendshëm', për të cilët është shumë e vështirë të hetohet për arsye se nuk ka pika kontakti të tyre dhe është i vështirë gjurmimi", shtoi Wray. "Zgjedhin objektiva jo të vështira, shfrytëzojnë armë të lehta për t'u përdorur si, për shembull, bombat artizanale, makina, thika dhe pistoleta", theksoi ai.
Wray garantoi se "FBI-ja po përpiqet t'i shqyrtojë më mirë sinjalet e alarmit që mund të tregojnë kur personat e radikalizuar mund të fillojnë të hyjnë në veprim".




## Danimarka tërheq forcat speciale nga Iraku

Kopenhagë, 17 maj - Rreth 60 forca speciale të Danimarkës do të tërhiqen nga Iraku, pasi që shumë zona të kontrolluara nga i ashtuquajturi Shteti Islamik janë çliruar. Mbështetja do të përfundojë në fund të vjeshtës, bën të ditur Ministria e Mbrojtjes e Danimarkës. Por, rreth 180 forca ushtarake ende do të qëndrojnë në bazën ajrore të al-Asadit në Irak dhe do të kontribuojnë në mbikëqyrje si



pjesë e një koalicioni ndërkombëtar që lufton grupin militant islamik.

## Hahn: Maqedonia dhe Greqia janë në rrugë të mirë

Shkup, 17 maj - Komisari evropian i Zgjerimit, Johannes Hahn, ka thënë se Maqedonia dhe Greqia janë në rrugë të mirë për ta zgjidhur çështjen, por ende nuk ka marrëveshje.



Ai ka theksuar se gjithnjë është optimist, por zgjidhje nuk ka ende. "Gjithnjë jam optimist. Mendoj se janë në rrugë të mirë por, sipas asaj që kuptova, puna nuk ka përfunduar", thotë Hahni.
I pyetur nëse deri në qershor mund të ketë diçka pozitive, Hahni thotë se ka një muaj e gjysmë deri atëherë dhe se shpreson se mund të ketë përparim që do të kishte efekt në samitin e qershorit.

# QUARTET SOCIOLOGICA



ALI PAJAZITI

Termi sociologji rrjedh nga fjala latine socius (fis ose qytet aleat i Romës, më vonë, shoqëri) dhe nga ajo greke logos (arsye ose dije) dhe shënon shkencën e përgjithshme shoqërore që hulumton ligjet e ekzistencës dhe të zhvillimit të shoqërisë, proceset e jetës shoqërore. Studimi i bazës së anëtarësisë shoqërore *(social membership)*, analizë e strukturës së marrëdhënieve shoqërore të ndërtuara nga ndërveprimi shoqëror. Sociologjia është shkencë që studion origjinën, historinë dhe ndërtimin e shoqërisë njerëzore. Termi i shpikur nga Comte më 1839 përdoret për studimin rigoroz, të arsyeshëm të shoqërisë (M. Mann). Përqendrohet në studimin e institucioneve shoqërore, të formuara më herët dhe në ato të themeluara nga transformimet industriale të dy ose tre shekujve të fundit. Ajo përfshin ndjeshmëri historike, antropologjike dhe kritike (Giddens). Sociologjia e lindur në shekullin XIX është një këndvështrim që, duke i marrë për gjedhe shkencat bashkëkohore natyrore, synon ta shpjegojë shoqërinë moderne që ka një strukturë krejtësisht të re dhe dallon nga e kaluara nga ana cilësive epistemologjike, ekonomike, politike dhe kulturore.

Veçoria bazë, e cila këtë paradigmë e ndau nga dituritë e mëparshme që i kishin pasur për subjekt njeriun dhe shoqërinë, ishte shpjegimi i ngjarjeve shoqërore në një mënyrë mekanike, duke marrë për bazë shoqërinë moderne. Sipas sociologut amerikan Smelser, sociologjia është studim shkencor i shoqërisë dhe i marrëdhënieve sociale. Ajo mbështetet në të dhëna ose fakte nga bota reale dhe synon t'i shpjegojë ato duke përdorur shpjegimin shkencor, "duke e parë të përgjithshmen në të pjesshmen" (Macionis & Plummer). Sipas Giddensit, është doktrinë mbi jetën sociale të njerëzve, mbi grupet dhe bashkësitë.

Sociologjia është rruga e posaçme e studimit të shoqërisë njerëzore (Hurd: 1986:1) Bazë e mendimit sociologjik është ideja se shoqëria i drejton veprimet dhe zgjedhjet tona jetike. Auguste Comtei e shihte si një "doktrinë të përparimit", si një trashëguese shekullare të teologjisë, e cila në të kaluarën ishte mbretëresha e shkencave; një "teologji e re" e pastruar nga elementet mbinatyrore të teologjisë. Sociologjia, sipas tij, duhet të ishte mbretëresha e re e shkencave. Edhe pse si ati i kësaj shkence konsiderohet Comtei, ndihmesë me vlerë kishin dhënë dy pararendës, njëri i largët, Ibën Halduni, tjetri i afërt, Saint Simoni.

Ndihmesa për zhvillimin e fushës, temës dhe metodës së sociologjisë kanë dhënë edhe E. Durkheim, G. Simmel, V. Pareto, K. Marks, M. Weber dhe të tjerë. Sociologjia eksperimentale e bazuar në studimet monografike të Le Playit, nga Amerika është përhapur anembanë botës. Por edhe përkundër një historie dyshekullore, dobishmëria e sociologjisë nuk është kuptuar ashtu siç duhet. Disa e shohin si një disiplinë çliruese, emocionuese dhe trimëruese, si inxhinieri sociale, pa të cilën s'mund të ndërtohet ardhmëria e një shoqërie, si një disiplinë të nevojshme për çdokënd që dëshiron të ketë dituri për shoqërinë dhe ngjarjet shoqërore. Sociologjia si disiplinë e ndihmon njeriun për ta kuptuar shoqërinë njerëzore, konstruksionet sociale, praktikat dhe proceset e ndryshimit social, ndërveprimet shoqërore. Me një fjalë, dukuritë që ndodhin në kondita sociale. Ndër çështjet me të cilat merret sociologjia janë: familja, marrëdhëniet etnike, ndryshimi shoqëror, shtresimi social, burokracia, pushteti, lëvizjet fetare, devijimi - listë kjo shumë e gjatë e çështjeve prej të cilave lindin edhe nëndisiplinat sociologjike, si sociologjia e kulturës, e fesë, e politikës, e së drejtës, e familjes, urbane, e artit, e historisë, e sportit, e modës etj. Në vazhdim do të shtjellojmë katër nëndisiplina sociologjike: sociologjinë e dijes, të moralit, të kohës së lirë dhe atë të modës.

**i.** Sociologjia e dijes *(ang. sociology of knowledge, gjerm. wissenssoziologie)*, degë e sociologjisë që merret me studimin e proceseve të përfshira në prodhimin e dijes, me kuptimin dhe shpjegimin e njohurive në rastet e veçanta si dhe me raportet ndërmjet formave të përgjithshme të dijes dhe të strukturës sociale, përfshirë këtu edhe efektet e dijes e të forcave shoqërore që e kushtëzojnë trajtën dhe përmbajtjen e dijes. Sociologjia e dijes i qaset konceptit në kuptimin më të gjerë: ajo përfshin gjithçka që një bashkësi e caktuar e kupton për dituri, pra jo vetëm njohuritë shkencore e filozofike (Shushnjiq). Sipas Sismondsit, sociologjia e dijes është me rëndësi qendrore për shkencat shoqërore, si metodë hermeneutike që merret jo me kërkimin e së vërtetës shkencore, por me interpretimin e kuptimit shoqëror. Pavarësisht prej epistemologjisë, kjo disiplinë "mundësinë e njohjes" e vë në kllapa, me fjalë të tjera, nuk merret me spekulime epistemologjike. Dihet se iluminizmi shkencave sociale ua diktonte programin për zhvillimin e një metodologjie të bazuar në të vërtetën e amshueshme dhe përftimin e ligjeve shkencore në bazë të metodës së shkencave natyrore. Detyra e veçimit të dijes së vërtetë nga dija e jo e vërtetë, e veçimit të dijes autentike nga paragjykimet historike, e formimit të një koncepti rreth natyrës dhe funksionimit të paragjykimeve i takon sociologjisë së dijes. Detyrë tjetër e sociologjisë së dijes është hulumtimi i mënyrës përmes së cilës faktorët e ndryshëm historikë dhe kulturorë e kanë formësuar, mjegulluar e shtrembëruar mendimin njerëzor. Që nga lindja e vet sociologjia e dijes i ka qëndruar besnike parimit të kërkimit të së vërtetës shkencore duke i përcaktuar edhe ato që pararendësi i kësaj disipline i ka quajtur "idhuj" që e rrethojnë mendjen e njeriut. Sociologjia e dijes e mohon prerazi konceptin iluminist për të vërtetën, ofron një projekt që e kapërcen dogmatizmin pozitivist-humanist. Kjo sociologji thelbin e shkencave sociale e përkufizon kështu: Shqyrtimi i lidhjes mes mendimit njerëzor dhe jetës shoqërore. Nëse si kriter që e përcakton praktikën e sociologjisë së dijes merret dallimi mes dijes së pastër dhe asaj të shtrembëruar, atëherë rrënjët e kësaj disipline arrijnë deri te vepra e Vicosë *Shkenca e re,* deri te ajo e Montesqueiusë *Shpirti i ligjeve*. Janë veprat e Max Schelerit dhe ato të Karl Manheimit ato që tregojnë fillimin e sociologjisë më sistematike të dijes. Në qarkun e sociologjisë së dijes mund të përfshihen edhe Marksi, Comtei, i cili është munduar të ndërtojë një shkencë për shoqërinë, Durkheimi si dhe Weberi, i cili shpalosi "sëmundjen metodologjike" të shkencave sociale. (Shih: Hekman, 1986; Šušnji?, 2005: 13)

**ii.** Sociologjia e moralit *(sociology of moral)*, disiplinë sociologjike që merret me institucionin e moralit si një hartë jetësore për sjelljet e njerëzve, si tërësi normash që tregojnë të mirën dhe të keqen, gjithherë duke synuar udhëzimin e njeriut nga e mira dhe e pëlqyeshmja dhe largimin e tij nga e keqja dhe sjelljet johumane. Sociologjia e moralit përbën një sferë të lidhur me sociologjinë e fesë dhe me atë juridike, sepse koncepti i moralit është i lidhur ngushtë me fenë dhe me botëkuptimet etike. Themelet e kësaj disipline i kanë vënë sociologët francezë, Durkheim dhe nxënësi i tij Lévy-Bruhl. Durkheimi në veprën *Ligjërata nga sociologjia (Leçons de sociologie)* e përcakton lëndën e sociologjisë së moralit si studim i lidhjeve mes moralit dhe shoqërisë, studim i mënyrës se si morali zbatohet në shoqëri. Sipas tij, detyra e shkencës mbi moralin (fizika e karakterit dhe e së drejtës), gjegjësisht e sociologjisë së moralit është shpjegimi i mënyrës se si këto norma kanë lindur, shkaqet që i kanë sjellë, përshkrimi dhe vlerësimi i dukurisë së moralit. Durkheimi shton se sociologjia e moralit duhet të jetë shkencë tipike shkakësore si, p. sh., fizika, dhe për këtë arsye e quan fizikë morale. Sipas Lévy-Bruhlit, sociologjia e moralit, të cilën e barazon me shkencën mbi moralin, duhet t'i verifikojë ligjet shkakësore me të cilat do të shpjegohet, duhet t'i përshkruajë refleksionet morale pozitive të shoqërive të periudhave të ndryshme kohore. Për Gurvitchin lënda e sociologjisë së moralit është studimi i lidhjeve mes moralit dhe dukurive shoqërore, kontekst ky në të cilin të rëndësishme janë lidhjet funksionale e jo ato shkakësore. Sipas tij, kjo sociologji e veçantë merret me këto çështje: llojet e moralit në grupet gjegjëse shoqërore, raporti mes sistemeve të jetës morale dhe grupeve shoqërore në të cilat këto sisteme trajtësohen, raporti mes moralit dhe normave të tjera shoqërore, raporti mes shoqërisë dhe doktrinave morale ose filozofive të moralit dhe studimi gjenetik i tij (lindja, ndryshimi dhe ndikimi i tij në shoqëri). Subjekt i sociologjisë së moralit janë koncepti i moralit, proceset morale si lindja, zbatimi, zhvillimi i normave morale në kontekstin social, baza (jo)shoqërore dhe funksioni i moralit, niveli i përputhjes mes sjelljeve të njerëzve dhe normave morale, marrëdhëniet mes traditave dhe strukturës shoqërore, dallimet në konceptimin e moralit në kuadër të grupeve dhe klasave të ndryshme shoqërore, llojet e moralit, ndikimi i transformimeve shoqërore në pikëpamjet e njerëzve ndaj moralit etj. Morali është dukuri e ndërlikuar, që ka dimensionin shoqëror dhe përmasat e tjera. Sociologjia s'mund ta studiojë atë në tërësinë e vet, por vetëm aspektin shoqëror të tij, pra ndikimin e shoqërisë në moral dhe të moralit në shoqëri (Özkalp, 1986: 17; Lukiq, 1976: 15-17).

**iii.** Sociologjia e kohës së lirë *(sociology of leisure)* paraqet një prej degëve më të reja të sociologjisë që, siç shprehet J. Fichteri, merret me njërin prej institucioneve shoqërore themeltare: koha e lirë, pushimi dhe zbavitja. Sociologjia e kohës së lirë merret me mënyrën se si njerëzit e kalojnë kohën e lirë, me marrëdhëniet e krijuara gjatë kësaj kohe, me veprimtaritë që zhvillohen jashtë kohës së punës. Shfrytëzimi i kohës së lirë, që përbën një të drejtë universale njerëzore, sanksionuar me ligje shtetërore, është një mënyrë e ripërfitimit të energjisë për veprimtaritë e ndryshme shoqërore. Kësaj disipline sociologjike i është kushtuar shumë pak kujdes. Sipas Parkerit dhe Giddensit, shkaqet janë vështirësia e zbatimit të metodave shkencore në fushën e kohës së lirë, perceptimi i kohës së lirë si e parëndësishme apo si veprimtari dytësore, madje edhe si burim i të gjitha të këqijave, si antipod i zellshmërisë dhe punës (Tezcan, 1994: 11).

**iv.** Sociologjia e modës *(sociology of fashion)*, degë e sociologjisë që ka si objekt studimi modën, qëndrimin e grupeve dhe të turmave shoqërore rreth modës dhe ligjësitë e veçanta që përcaktojnë zhvillimin dhe evoluimin e modës. Trajton faktorët e përgjithshëm shoqërorë (ekonomikë-prodhues) dhe ata të veçantë, që janë të lidhur me psikologjinë shoqërore (proceset e imitimit etj.), elementet estetike dhe krijuese në fushën e modës. Shumica e hulumtimeve rreth modës kanë të bëjnë me veshjen, por Aspers argumenton se nuk ka korniza të fushave që duhet t'i kufizojnë teoritë e modës. Sociologjia e modës kap një spektër të gjerë të çështjeve: moda si fakt shoqëror, evolucioni i modës, sjellja dhe moda, tradita, feja dhe moda, përcaktimi shoqëror-klasor dhe moda, nevojat, prestigji shoqëror dhe moda, përhapja e modës, inovacionet dhe moda, snobizmi dhe moda, erotizmi dhe moda, koha e lirë dhe moda, arti dhe moda, personaliteti dhe moda, bartësit e zhvillimit të modës etj. R. Königu thotë se sociologjia e modës është pjesë e sociologjisë së turmave dhe psikologjisë sociale, kurse sociologu amerikan Leslie White modën e përfshin në kuadër të shkencës mbi kulturën (kulturologjisë) (Aspers, 2013: 171-192).

## Përfundim

Të dhënat empirike flasin se në shkencën shqiptare këto nëndegë të sociologjisë nuk janë në qendër të vëmendjes, se nuk trajtohen si duhet, nuk "lëvrohen" me seriozitet dhe se nuk janë zhvilluar në nivelin e duhur për t'i kontribuar kulturës sonë shkencore dhe të mirës kolektive. Ekzistojnë shumë pak tekste autoriale që me sfond akademik dhe me metodologji të mirëfilltë trajtojnë problematika që kanë të bëjnë me këtë kuartet. Edhe sondazhet me shkollarë dhe studentë e vërtetojnë deficitaritetin e njohurive për këto nëndisiplina. Andaj duhet që nëpër kurrikulat universitare dhe katedrat e sociologjisë të përfshihen lëndë dhe module që mundësojnë të kuptuarit e këtyre subjekteve shkencore me peshë si për teorinë, po ashtu edhe për praktikumin sociologjik. Kultura sociologjike e një populli nuk mund të mbindërtohet vetëm mbi gjashtë e shtatë disiplina klasike; duhet të zhvillohen edhe syresh si këto katër të përmendurat, madje edhe krejtësisht të reja si sociologjia vizuale, e streseve të jetës, e terrorizmit e të ngjashme.

***(Marrë nga numri i dytë i revistës për kulturë, gjuhë dhe media, "Akademia")***

**Literatura:**

*Aspers, Patrik, "Sociology of Fashion: Order and Change", në?Annual Review of Sociology, 39:171-192, korrik 2013?*

*Hekman, Susan, Hermeneutics and the Sociology of Knowledge, University of Notre Dame Press, 1986*

*Llukiq, Radomir, Filozofia e së drejtës, shqipëroi dhe përshtati Osman Ismaili, Prishtinë, 2008*

*Özkalp, Enver, Sosyolojiye Giri? Dersleri, T. C. A. Ü., Eski?ehir, 1986*

*Pajaziti, Ali, Fjalor i sociologjisë, botimi i dytë, Logos-A, Shkup, 2017*

*Smelser, Neil, Theory of Collective Behaviour, Free Pres, New York, 1962*

*Šušnji?, Djuro, Metodologija, botimi i tretë, ?igoja Štampa, Beograd, 2005*

*Tezcan, Mahmut, Bo? Zamanlar?n De?erlendirilmesi Sosyolojisi, Atilla Kitabevi, Ankara, 1994*

# FRANKENSTEINI NË BAGDAD



**AHMED SAADAWI**

*Ahmed Saadawi (1973) është shkrimtar irakian. Shkruan prozë, poezi, skenarë për filma artistikë dhe dokumentarë. Me veprën "Frankenshtajni në Bagdad" në vitin 2014 fitoi Çmimin Ndërkombëtar për Fiksion Arab. Saadawi jeton dhe punon në Bagdad.*

Hasib Mohamed Jaafari ishte 21 vjeç, zeshkan, hollak dhe i martuar me Dua Jaabarin. Jetonte me Duan dhe foshnjën e tyre, Zahra, në Sektorin 44 në Qytetin Sadr, në një dhomë, në shtëpinë e familjes së tij të madhe. Hasibi, i cili kishte shtatë muaj që po punonte si rojtar në hotelin "Sadeer Novotel", u vra në një shpërthim të shkaktuar prej një kamikazi sudanez që e drejtoi një kamion mbeturinash me eksploziv, të vjedhur nga shërbimet komunale të Bagdadit. Bombarduesi po planifikonte të kalonte me kamion nëpërmjet portës së jashtme, ta drejtonte mu në hollin e hotelit dhe detononte eksplozivin që ta shembte tërë hotelin. Ai dështoi për shkak se rojtari e shkrepi trimërisht armën në drejtim të shoferit, duke e detyruar ta aktivizonte para kohe eksplozivin. Gjësendet e rojtarit iu dorëzuan familjes: rrobat civile, një palë çorapë, një shishe kolonjë dhe vëllimi i parë i poemave të mbledhura të Al-Sayyabit. Në arkivol ia futën këpucët e djegura, veshjet e përgjakura e të grisura dhe gjymtyrë të vogla të copëtuara të trupit.

Nuk është se kishte mbetur kushedi sa prej trupit të Hasib Mohamed Jaafarit; arkivoli që u dërgua në varrezat e Naxhafit ishte më shumë si shenjë kujtimi. Gruaja e re e Hasibit u hodh mbi arkivol, u shkreh në vaj dhe vajtoi me shpirt. Nëna, motrat dhe vëllezërit, si dhe fqinjët, shpërthyen në lot, dhe vajza e tij e vogël kalohej prej dorës në dorë sa herë që ai që e kishte në duar nuk mund ta përmbante mërzinë.

Të këputur me shpirt, krejt familjarët ranë në gjumë duke ëndërruar Hasibin që po kthehej në shtëpi me një çantë krahëve. Krejt ëndërronin diçka për Hasibin. Pjesët e një ëndrre përshtateshin me pjesët e munguara në ëndrrën tjetër.

Një ëndërr e vogël e mbushte boshllëkun në të madhen dhe fijet ndërthureshin bashkë për rikthimin e një trupi ëndrre për Hasibin, që do të bashkohej me shpirtin, që po rrinte pezull mbi kokat e tyre dhe kërkonte pjesën tjetër që nuk po e gjente dot. Ku mbet trupi që duhej t'i kthehej për të zënë vend ndër ata që jetonin në një gjendje ankthi?

Kur Hasibi e pa kamionin e bërllokut, shpjegime të ndryshme shkuan vetëtimthi nëpër mend. Ishte thjesht kamion bërlloku. Shoferi, thjesht, kishte gabuar - kishte humbur kontrollin dhe ia kishte mësyrë portës së hotelit. Ishte aksident i zakonshëm trafiku, dhe shoferi krejt instinktivisht klithte kthyer timonin dhe paqëllimshëm u turr drejt portës. Jo, nuk bëhej fjalë për sulmues vetëvrasës. Ndal! Ndal! Shkrepja e parë. Pastaj tjetra. Nuk e kishte ndërmend ta vriste shoferin. Nuk kishte guxim të vriste askënd, por e kishte detyrë. E dinte fort mirë se cilët ishin urdhrat e rrepta për mbrojtjen e hotelit. Kishte kompani sigurimesh dhe njerëz të rëndësishëm në të, mbase edhe amerikanë. Kishte, siç thuhet, licencën për vrasje. Këto mendime iu sollën nëpër kokë vetëtimthi derisa gishti e tërhoqi këmbëzën, mbase para se ta ndante mendjen për kursin e veprimit. Kamioni u hodh në erë, dhe Hasibi po e shikonte me vetëdije shpërthimin, por jo ndërmjet pozicionit të tij ndërmjet kapisë së drunjtë të rojtarëve dhe portës së madhe të hotelit. Po i shikonte flakët, tymin dhe copat metalike që po fluturonin në qiell. Ndjeu një qetësi të çuditshme.

Pa një burrë me një çantë të madhe që po fluturonte dhe që u plandos goxha larg prej vendit të shpërthimit. Pa se po binin copa xhamash të hotelit dhe fasadën e copëtuar të mureve ballore të hotelit. Pas pak çastesh, u shpërnda reja e tymit dhe u desh të kalonin gjysmë ore derisa erdhën ambulancat dhe zjarrfikësit.

Pa se në qytet kishte rënë terri. Në largësi shihte dritat e ndërtesave, shtëpive dhe makinave. Po shihte disa prej mbikalimeve të rrethinës. Dritat e stadiumit dhe disa minare në largësi që po shkëlqenin prej dritave.

Po e shihte edhe lumin, i thellë dhe i zi në terrishtë. Donte ta prekte. Kurrë s'e kishte prekur ujin e lumit. Gjithë jetën e lume e kishte jetuar larg lumit. E kishte këputur me makinë, e kishte parë nga largësia dhe kishte parë fotografi të lumit në televizor. Por kurrë s'e kishte ndjerë ftohtësinë e ujit. Kurrë s'e kishte shijuar. Pa një burrë me kanotiere të bardhë dhe pantallona të shkurtra të bardha që po pluskonte në të. Çfarë qejfi! Duhet të jetë duke kundruar yjet, të kthjelltë në qiellin e natës. Po endej bashkë me rrymën. Hasibi u nis drejt tij dhe ia nguli sytë. "Çka m'i ke ngulur sytë, biri im?" - iu drejtua burri. "Shko e merre vesh çfarë ndodhi me trupin tënd. Mos rri këtu". Pa edhe një tjetër kufomë, që përmbys po e bartte rryma e ujit. Kufoma nuk e nxori asnjë fjalë ngoje. Po endej ngadalë në heshtje.

Hasibi u kthye te porta e hotelit dhe në sy i ra një birë e madhe që e kishte krijuar kamikazi me kamionin-bombë. Ia njohu çizmet e djegura, por nuk po mund ta gjente kufomën. Këqyri nëpër të gjitha rrugët dhe në Sheshin Firdaus, pastaj shkoi në Sheshin Tahrir dhe pa zogj që ishin ulur në figura të bronzta që përbënin Monumentin e Lirisë. Pastaj i ra puna të kalkonte kah varrezat.

Atje, në Luginën e Paqes në Naxhaf, i këqyri të gjitha varrezat. Nuk pa kurrfarë shenje që i krijonte qartësi, por në fund pa një riosh me kanotiere të kuqe, me një byzylykë të argjendtë në kyçe dhe një qafore të zezë. Ishte ulur këmbëkryq mbi dheun e ngritur të një varri.

"Çka ke dalë këndej?" - e pyeti rioshi. "Duhet të mos i ndahesh trupin tënd".

"Më është zhdukur".

"Qysh u zhduk? Duhet ta gjesh, ose ndonjë trup tjetër a gjërat e tjera do të shkojnë keq".

"Për çka e ke fjalën?"

"Nuk e di, por gjithmonë gjërat shkojnë mbrapsht".

"Çka po kërkon këtu?'

"Ky është varri im".

"Ky është varri im. Trupi më prehet nën dhe. Pas pak ditësh nuk do të mund të dalë mbi dhe. Trupi po më dekompozohet, dhe do të burgosem në varr deri në fund të kohës".

Hasibi u ul pranë tij, i shastisur. Çfarë duhet të bënte? Askush nuk i kishte folur kurrë për gjëra të tilla. Çfarë hataje e priste tani?

"Mbase ju s'keni vdekur përnjëmend dhe po ëndërroni. Ose, mbase shpirti e ka lejuar trupin tënd të dalë të shëtisë dhe do të kthehet më vonë", tha djaloshi.

"Dashtë Zoti e paçi të drejtë! Nuk jam mësuar kështu. Jam ende i ri, dhe kam një vajzë, dhe...".

"I ri! Ju nuk jeni i ri si unë!"

Hasibi vazhdoi muhabetin me djaloshin me byzylykë të argjendtë. Djaloshi ia kujtonte se duhej të kthehej në trupin e tij, sepse nëse do të donte Zoti, mund t'ia falte edhe një jetë.

"Nganjëherë trupi të braktisë dhe ju vdisni, por pastaj Engjëlli i Vdekjes ndërron mendje ose korrekton gabimin, dhe shpirti kthehet brenda trupit të vet. Pastaj Zoti e urdhëron trupin të ngjallet. Me fjalë të tjera, shpirti është si puna e naftës në makinë. I duhet vetëm një shkëndijë për ta ndezur".

Ata nuk e çelën gojë një copë herë, pastaj Hasibi dëgjoi dënesjen në largësi dhe pa disa qenë të zinj korb që po përlaheshin. Djaloshi me byzylykë po e zhbironte ankthshëm. "Më mirë, merre vesh ku të ka shkuar trupi", i tha ai, "se ndryshe gjërat do të shkojnë keq".

Hasibi u kthye në hotel dhe shikoi zhbirueshëm të gjitha rrugët përreth. Pas shumë orësh rrugëve, shkoi në shtëpi dhe pa se të gjithë po flinin: gruaja, e bija bebe dhe krejt familja. Dhe pak pa zbardhur dita, u kthye te skena e vdekjes. E kuptoi se ishte kurthuar në një rreth vicioz.

Në një shtëpi në Bataween, ai pa një burrë që po flinte zhveshur. Iu afrua dhe këqyri mos ishte i vdekur. Nuk ishte ndonjë i njohur; burri dukej i çuditshëm dhe i tmerrshëm. Kur pa se qielli po ndërronte ngjyrën, Hasibi ndjeu se vetëm lindja e diellit do t'ia hiqte qafe të zezat. Nuk do ta kishte energjinë që të bridhte rrugëve a të kthehej në skenën e eksplodimit. Me dorën e qelbur, preku xhenazen lakuriq dhe pa se shpirti i tij u fut në të. Edhe kraharori po futej, pastaj koka dhe pjesa tjetër e trupit. I dërmuar prej rëndesës dhe plogështisë, u lëshua brenda xhenazes, duke e mbushur kokë e këmbë. Pastaj e kuptoi se xhenazja nuk kishte shpirt, derisa vetë ishte shpirt pa trup. Kësisoj, i bie se gjërat nuk ishin zhvilluar pa ndonjë arsye? Dytë kishin lindur për njëri-tjetrin. Tani vetëm duhet të priste që familja e burrit të zhveshur ta çonte xhenazen në varreza, ta varroste dhe t'ia hidhte dheun. Nuk e kishte dert çfarë emri i kishin shkruar në gurin e varrit.

*(Teksti është marrë nga romani i Ahmed Saadawit, "Frankensteini në Bagdad", kurse është botuar në revistën për kulturë, gjuhë dhe media, "Akademia". Hadi po krijon një trup prej gjymtyrëve të gjetura nëpër Bagdad por, pas një vdekjeje të papritur, është shpirti i Hasib Mohamed Jaafarit ai që mishëron eshtrat e mbledhur. Ahmed Saadawi ka fituar në vitin 2014 Çmimin Ndërkombëtar për Fiksion Arab me veprën "Frankensteini në Bagdad". Është autori i parë irakian që e ka fituar këtë çmim. Tekstin e përktheu nga anglishtja: Rexhep Maloku)*

# Strategjitë dhe fuqia ushtarake e Iranit

**Edhe pse financiarisht jo fuqi e madhe Irani për të kompesuar dobësinë relative mbështetet ushtarakisht tek aftësitë asimetrike. Strategji kjo me sa duket e suksesshme**


© picture-alliance/AP Photo/E. Noroozi

Irani është forcë e madhe ushtarake në Lindjen e Mesme, me 534 mijë persona aktivë në ushtri, marinë, forcë ajrore dhe Korpusin e Gardës së Revolucionit Islamik (IRGC). Indexi botëror, Global Firepower Index, një faqe interneti që bën renditjen online të fuqive ushtarake, e klasifikon Iranin në vendin e 13 në 136 vendet e botës.

Kjo renditje bëhet në bazë të 50 faktorëve, përfshirë edhe potencialin e aftësisë për luftë të forcave jokonvencionale (jo nukleare), fuqisë së ushtrisë, gjeografisë dhe financave. Për të bërë një krahasim me fuqi të tjera rajonale, po themi se Turqia radhitet e nënta, kurse Egjipti i 12-ti, Izraeli i 16-ti dhe Arabia Saudite e 26-ta.

Popullsia e Iranit prej 82 milionësh, tregon se ushtria mund të rritet. Ky është një faktor kyç në zgjatjen e luftrave, siç zgjati luft Iran- Irak, midis 1980 -1988 Sidoqoftë, buxheti prej 16 miliardë dollarë në vitin 2017, nuk mund të krahasohet me rivalët e veçantë rajonalë dhe është i vogël në krahasim me shpenzimet për mbrojtjen që bëjnë vendet me të cilat Irani mund të hynte në konflikt: si për shembull buxheti i Izraelit prej 18.5 miliardë dollarë (plus 3.5 miliardë dollarë ndihma ushtarake prej SHBA), i Arabisë Saudite 76.7 miliardë, dhe Shteteve të Bashkuara prej 600 miliardë dollarë.


© Getty Images/AFP/J. Marey

### Asimetria strategjike përgjigje për disavantazhet

Irani shiit është financiarisht peshë e vogël për ato vende që ai i sheh si kërcënime ushtarake, Shtetet e Bashkuara, Izraeli dhe shtetet arabe të Gjirit, të cilat janë sunite. Po ashtu vendi është i rrethuar nga baza ushtarake amerikane dhe atij i mungon garancia e sigurisë që rivalët - arabët e Gjirit dhe Izraeli marrin prej Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Përveç kësaj Irani ka vuajtur katër dekada me radhë nën embargon e Shteteve të Bashkuara dhe që prej 2006 nën kufizimin e armatimit prej Kombeve të Bashkuara. Kjo e ka detyruar Iranin të mbështetet tek prodhimi vendas i armëve. Ndërkohë, rivalët e Iranit kanë siguruar sisteme të avancuara armësh nga Perëndimi.

Për të kompesuar dobësinë e tij relative, Teherani mbështetet tek aftësitë asimetrike dhe tek masat parandaluese për uljen e kostove.

### Mbrojtje përpara

Një nga pikat e strategjisë iraniane të mbrojtjes është "mbrojtja përpara" kryesuar nga operacionet speciale të Quds Force të IRGC. Strategjita përfshin përdorimin e aleatëve rajonalë dhe përfaqësuesve të tyre, e njohur si "aksi i resistencës", si levë për të goditur, mposhtur, apo luftuar armiqtë e Iranit që të qëndrojnë larg tokës iraniane.

Disa grupe, përfshirë edhe Njësitë e mobilizimit popullor në Irak që luftojnë "Shtetin Islamik", shiitë militantë të huaj luftojnë në emër të Sirisë, mike e Iranit; grupet shiite libaneze të hezbullahut, rebelët Houthi në Jemen, dhe xhihadi islamik palestinez. Irani pra është një nga vendet rajonale që ka influencë mbi grupet palestineze të Hamasit në Rripin e Gazës.

Megjithëse aleate me Iranin politikisht dhe militarisht, këto grupe kanë shkallë të ndryshme reagimi dhe interesave politike lokale aty ku veprojnë.

### Raketa balistike

Një pikë tjetër e rëndësishme e strategjisë ushtarake të Iranit, janë raketat balistike me rreze të shkurtër, të mesme dhe mbi të ndërmjetme të afta për të goditur Izraelin, shtetet arabe të Gjirit, bazat ushtarake amerikane në rajon dhe pjesë të Evropës.

Siç thekson Grupi Ndërkombëtar i Krizave, Irani i shikon këto raketa balistike si masa parandaluese kundër Izraelit, dhe në rast se Irani goditet atëherë armiqtë do të kundërgoditen në tokën e tyre ose në bazat ushtarake amerikane në rajon. Irani i shikon armët balistike si armë mbrojtëse, armiqtë e tij i konsiderojnë ato si rrezik ofensiv.

Politika e raketave balistike mund të kombinohet me politikën e mbrojtjes përpara, si përshembull sulmet me armë balistike të rebelevë jemenitë Hauthi kundër Arabisë Saudite, si përgjigje për luftën e saj në Jemen dhe armatimin e hezbullahëve nga Irani me një seri raketash kundër Libanit. Irani nuk pranon të ketë armatosur houthit me komponentë të raketave balistike. (gazeta-Shqip.com) / DW




© DW/S. Tanha

E jashtëzakonshme

## Shpenzon 220 mijë dollarë për të jetuar në një avion



68-vjeçari Bruce Campbell, i pamartuar dhe në pension, e ka kthyer në shtëpi një avion të prodhuar nga Boeingu, i cili mund t'i bartë 149 deri në 180 persona në bord. Ish-inxhinieri i avionëve e ka zhvendosur Boeingun nga Greqia në tokën e tij prej 10 hektarësh jashtë Portlandit në Oregon. Për këtë iu desh të shpenzojë 220 mijë dollarë.

FOTO E DITES




Një erë fryn mantelin e Papa Françeskut teksa lexon mesazhin e tij gjatë audiencës së përjavshme javore në Sheshin e Pjetrit në Vatikan. /AP/

E rrallë

## Gjen para, diamante dhe ari në kopshtin e shtëpisë



Një çift në ishullin Staten derisa po mbillte pemë në kopshtin e pasmë të shtëpisë u trondit kur zbuloi kuti metalike të mbushur me ari, diamante dhe para. Matthew dhe Maria Emanuel po zëvendësonin disa pemë kur bënë zbulimin e pabesueshëm me vlerë 38 mijë paundësh. Ata kishin katër vjet që jetonin në atë shtëpi, por nuk kanë qenë në dijeni të thesarit derisa filluan gërmimet për vendin e pemëve.

## BARSOLETA E DITËS



**Dy policë shkojnë ta marrin rrogën dhe e shohin listën: Kamberi 150 euro, Ndoci 150 euro. Totali: 300 euro.**
**Ndoci pyet: Kush është Totali që nuk e kemi parë kurrë në punë dhe po merr rrogë sa në të dy bashkë?**

KINO ABC PRISHTINE

## Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

**Vetem gjate vikendit në ora 15:00**

### "AVENGERS: Infinity War" 3D,

Aksion/Aventurë/Fantazi; 2 orë 29 min

**Rolet:** Robert Downey Jr., Chris Hemsworth, Mark Ruffalo, Chris Evans, Scarlet Johansson, Tom Holland, Zoe Soldana, Josh Brolin, Chris Pratt, etj.

**Regjia:** Anthony Russo, Joe Russo






**Në ora 18:00**

### "ISLE OF DOGS"

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 41 min

**Rolet:** F. Murray Abraham, Bryan Cranston, Greta Gerwig, Jeff Goldblum, Akira Ito, Scarlett Johansson, Harvey Keitel, Frances McDormand, Bill Murray, Yoko Ono, Liev Schreiber, Fisher Stevens, Tilda Swinton, etj.

**Regjia:** Wes Anderson

